



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 12/220  
Datë: 11.09.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 shtator 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Ndihmë Juridike Falas.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E DREJTËSISË**  
**MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE**

**KONCEPT DOKUMENT**  
**PËR**  
**NDIHMË JURIDIKE FALAS**

**Gusht, 2024**

# Përmbajtja

|  |    |
|--|----|
| Përmbledhje e Koncept dokumentit   | 4  |
| Hyrje  | 5  |
| Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit   | 7  |
| 1.1. Hyrje   | 7  |
| 1.2. Vlerësim i legjislacionin vendor të kritereve për ndihmë juridike falas me fokus në rastet penale | 8  |
| 1.3. Vlerësimi i gjendjes aktuale lidhur me ofrimin e ndihmës juridike në Kosovë                       | 14 |
| 1.3.1 Volumi i ndihmës juridike të financuar nga shteti  | 15 |
| 1.3.2 Sfidat dhe mangësitë lidhur me volumin e ndihmës juridike  | 26 |
| 1.3.3. Cilësia e ndihmës juridike që ofrohet në Kosovës  | 29 |
| 1.3.3.1 Sfidat dhe mangësitë në cilësinë e ofrimit të ndihmës juridike                                 | 30 |
| 1.3.3.2. Kostoja e ndihmës juridike që ofrohet aktualisht në Kosovë                                    | 34 |
| 1.4. Lista e dokumenteve të politikave dhe ligjeve në fuqi   | 38 |
| 1.5. Pema e problemit  | 51 |
| 1.5.1. Shkaqet   | 52 |
| 1.5.2. Efektet   | 52 |
| 1.5.3. Palët e interesuara   | 54 |
| 1.6. Analiza krahasuese  | 58 |
| Kapitulli 2: Objektivat  | 60 |
| Kapitulli 3: Opsionet e shqyrtuara   | 61 |
| Kapitulli 3.1: Opsioni i parë - pa asnjë ndryshim  | 61 |
| Kapitulli 3.2 Opsioni i dytë - i ndërmjetëm (Modeli Hibrid)  | 62 |
| <b>Përparësitë dhe mangësitë e Opsionit të dytë:</b>   | 67 |
| Kapitulli 3.3 Opsioni i tretë- Sistemi i Pastër i Mbrojtësve Publik                                    | 68 |
| <b>Përparësitë dhe mangësitë e Opsionit të Tretë</b>   | 73 |
| Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme  | 74 |
| Kapitulli 4.1. Ndikimet shoqërore  | 74 |
| 4.1.1. Ndikimet në të drejtat e qytetarëve   | 75 |
| 4.1.2. Ndikimet në informimin më të mirë të publikut   | 75 |
| Kapitulli 4.2. Ndikimet në drejtat themelore   | 75 |
| 4.2.1. Mbikëqyrja dhe monitorimi i ndihmës juridike falas  | 76 |
| 4.2.2. Qasja në drejtësi   | 76 |

|  |     |
|--|-----|
| Kapitulli 4.3. Ndikimet buxhetore                                  | 76  |
| Kapitulli 4.4: Sfidat me mbledhjen e të dhënave                    | 78  |
| Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi                             | 78  |
| Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve                                 | 80  |
| Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme           | 83  |
| Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet              | 92  |
| Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm                     | 93  |
| Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin           | 99  |
| Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik                | 100 |
| Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore               | 103 |
| Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore               | 107 |
| Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore | 110 |

## Përmbledhje e Koncept dokumentit

| <b>Informacionet e përgjithshme</b> |   |
|-------------------------------------|---|
| Titulli                             | Koncept Dokumenti për Ndihmë Juridike Falas   |
| Ministria bartëse                   | Ministria e Drejtësisë  |
| Personi kontaktues                  | Anita Alaj - Kalanderi,<br>Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë   |
| Plani Strategjik operacional        | Aktiviteti 2.1.8  |
| Prioriteti strategjik               | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, Plani Strategjik Operacional -“Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative”. |

| <b>Vendimi</b>             |  |
|----------------------------|--|
| Çështja kryesore           | Realizimi i qasjes në drejtësi me qëllim të mbrojtjes dhe realizimit të së drejtave të njeriut |
| Përmbledhje e konsultimeve | Do të plotësohet pas konsultimit   |
|                            | Do të plotësohet pas konsultimit   |
| Opsioni i propozuar        | Hartimi dhe miratimi i Ligjit që do të avancohet dhe zhvillon ndihmën juridike falas           |

| <b>Ndikimet kryesore të pritshme</b>   |  |
|--|--|
| Ndikimet buxhetore                     | Priten ndikime buxhetore   |
| Ndikimet ekonomike                     | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta   |
| Ndikimet shoqërore                     | Ndikime në të drejtat e punëtorëve dhe informimin më të mirë të publikut |
| Ndikimet mjedisore                     | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta   |
| Ndikimet ndër-sektoriale               | Ndikime në të drejtat themelore të njeriut                               |
| Ngarkesat administrative për kompanitë | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta   |
| Testi i NVM-ve                         | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta   |

| <b>Hapat e ardhshëm</b> |   |
|-------------------------|---|
| Afatshkurtër            | Ligji i ri për Ndihmën Juridike Falas   |
| Afatmesëm               | Unifikimin e mekanizmave institucional aktual në një mekanizëm që ofron ndihmë juridike falas |

# Hyrje

Figura 1 - Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

| Titulli               | KONCEPT DOKUMENTI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS   |
|-----------------------|---|
| Ministria bartëse     | Ministria e Drejtësisë  |
| Personi kontaktues    | Anita Alaj - Kalanderi,<br>Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë   |
| PSO                   | Aktiviteti 2.1.8  |
| Prioriteti strategjik | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, Plani Strategjik Operacional -“Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative” .  |
| Grupi punues          | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Anita Alaj - Kalanderi, ZSP/MD, Kryesuese</li> <li>2. Flutura Zena, ANJF/MD, Zëvendës-kryesuese</li> <li>3. Bujar Muzaqi, Gjyqtar në Gjykatën Apelit, anëtar</li> <li>4. Mehreme Hoxha, Këshilli Prokurorial i Kosovës, anëtar;</li> <li>5. Armend Latifi, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, anëtar;</li> <li>6. Agron Curri, Oda e Avokatëve të Kosovës, anëtar;</li> <li>7. Hamit Rukiqi, Policia e Kosovës, anëtar;</li> <li>8. Gëzim Bislimi, Ministria e Financave Punës dhe Transferove;</li> <li>9. Alberita Hyseni, Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, anëtare;</li> <li>10. Habit Hajredini, Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, anëtar</li> <li>11. Vjosa Hoxha, Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Zyra e Kryeministrit, anëtare;</li> <li>12. Leonora Selmani, Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, anëtare</li> <li>13. Muhamet Vokri, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti Juridike, Anëtar</li> <li>14. Berita Abazi, Kabineti i Ministres së Drejtësisë;</li> <li>15. Albert Selimi, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në Ministri të Drejtësisë, anëtar</li> <li>16. Faton Jashari, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Anëtar;</li> <li>17. Besnik Gashi, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, anëtar;</li> <li>18. Ardian Mehmeti, Departamenti Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë, anëtar;</li> <li>19. Shqipe Prekaj, Departamenti për Shërbime Sociale dhe Familjare, anëtare;</li> <li>20. Florentina Beqiraj, Njësia për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Drejtësisë, anëtare;</li> <li>21. Nexhat Sylja, Divizioni për Buxhet dhe Financa në Ministrinë Drejtësisë, anëtar</li> <li>22. Yll Zekaj, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, anëtar;</li> <li>23. Fidan Hyseni, QMGD “Raba Voca”</li> <li>24. Zana Asllani, Koalicioni i Strehimoreve në Kosovës, anëtare</li> <li>25. Anton Nrecaj, CLARD, anëtar;</li> <li>26. Eranda Zeka, IKD, anëtare</li> <li>27. Rina Braimi, CEL, anëtare;</li> <li>28. Arbër Nuhiu, CSGD, anëtar;</li> <li>29. Senad Ibishi, VORAE, anëtare;</li> </ol> |

- |  |   |
|--|---|
|  | 30. Blerim Shabani, Asociacioni i QPS-ve, anëtar;<br>31. Adelina Rexhepi Braha, Asociacioni i QPS-ve; |
|--|---|

# Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

## 1.1. Hyrje

Ndihma juridike falas është një fushë mjaftë e rëndësishme, bazuar në faktin se është e drejtë për personat që kanë nevojë dhe nga ajo duhet të përfitojnë kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë. Strategjia për Sundimin e Ligjit (2021-2026) ka identifikuar nevojën për reformimin e këtij sistemi duke marrë parasysh se aktualisht ekzistojnë tre forma krejtësisht të ndryshme financimi për ndihmën juridike falas (1) financimin nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) për ndihmë juridike në çështje civile, administrative, penale dhe kundërvajtëse (2) financimi nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) për ndihmë juridike penale (*sipas detyrës zyrtare*) që ofrohet në fazat e hetimit pranë policisë dhe prokurorëve të shtetit dhe (3) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) për ndihmë juridike penale falas (*ex-officio ose sipas detyrës zyrtare*) që parashikohet në fazat gjyqësore (shqyrtuese) të procedimit penal. Në Kosovë gjithashtu ofruet të ndihmës juridike falas janë një numër i organizatave jo qeveritare, të cilat kryesisht funksionojnë me projekte zhvillimore nga donatorët ndërkombëtarë.

Ky Koncept Dokumenti analizon kornizën ligjore edhe institucionale të ndihmës juridike falas në Kosovë me theks të veçantë në volumin e ndihmës juridike për personat në nevojë dhe volumin e ofruar realisht, pastaj cilësinë dhe koston e ndihmës juridike të ofruar, efikasitetin, por edhe ofrimin e qasjes në drejtësi për grupet e marginalizuara.

Ky Koncept Dokumenti është bazuar në analiza dhe studime të ndryshme nga Ministria e Drejtësisë (Agjencia për Ndihmë Juridike Falas) dhe organizatat tjera, siç janë:

- Dokumenti i Politikave për Qasjen në Drejtësi nga Procesi i Rishikimit Funksional të Sundimit të Ligjit (2019)
- Raporti i OSBE-së për Ndihmën Juridike në lidhje me sistemin e ndihmës juridike penale *sipas detyrës zyrtare*;
- një sërë intervistash të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar me palët kryesore të interesit (ANJF, MD, anëtarët e OAK, avokatë privatë, donatorë të tjerë, etj.);
- studimi i shkurtër sasior i statistikave për të përcaktuar gjithësinë e rasteve të ndihmës juridike dhe kërkesën për të njëjtën, si dhe masën në të cilën kërkesa po përmbushet aktualisht si në fushën e së drejtës civile/administrative ashtu edhe në atë penale;
- realizimi i fokus grupit lidhur me kënaqshmërinë e përfituesve dhe cilësinë e ndihmës juridike me shtatë (7) përfitues të ndihmës juridike falas të ofruar nga zyrtarët ligjor të ANJF-së dhe përfitues të përfaqësimit ligjor të ofruar nga ANJF (përmes avokatëve të caktuar nga lista e OAK-së);



- analiza të buxhetit aktual për ndihmën juridike në Kosovë;
- analiza krahasuese të praktikave më të mira rajonale dhe ndërkombëtare në Evropë dhe në pjesën tjetër të botës në lidhje me modelet e ofrimit të ndihmës juridike të detyrueshme në çështje penale si dhe ndihmës juridike në çështje civile/administrative;
- analiza kosto/përfitim e rekomandimit teknik për konvertimin e një pjese ose të gjithë ofrimit të ndihmës juridike të financuar nga shteti në Kosovë në një model me burim unik bazuar në përdorimin ekskluziv të avokatit mbrojtës nga stafi i ndihmës juridike me orar të plotë, si dhe një vështrim nga afër të avantazheve dhe disavantazheve të sistemit të tillë.

## 1.2. Vlerësim i legjislacionin vendor të kriterëve për ndihmë juridike falas me fokus në rastet penale

Kushtetuta e Kosovës garanton të drejtën për ndihmë juridike për çdo individ të akuzuar (neni 30), ku përcaktohet e drejta e personit që t’i sigurohet mbrojtja falas në rast se nuk ka mjete të mjaftueshme. Përveç procedurës penale, Kushtetuta e Kosovës (neni 31, paragrafi 6), garanton ofrimin e të drejtës për ndihmë juridike edhe në procedura tjera duke përcaktuar që “Ndhima juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.” Ndhima juridike falas në Republikën e Kosovës është e rregulluar më hollësisht dhe mund të ushtrohet sipas kushteve të përkufizuara me Ligjin për Ndhimën Juridike Falas (në çështje civile, administrative, penale dhe kundërvajtje)<sup>1</sup> dhe me Kodin e Procedurës Penale të vitit 2022, në çështje penale (që do të diskutohet në detaje më poshtë).

Garantimi kushtetues i së drejtës për ndihmë juridike e detyron shtetin të sigurojë kushtet për ofrimin e kësaj të drejte.

E drejta për ndihmë juridike është një nga të drejtat kushtetuese që shteti garanton për krijimin e mundësive të barabarta për përdorimin efektiv të të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare (neni 19 i Kushtetutës).

Në Republikën e Kosovës ka sfida dhe kufizime serioze për sa i përket gëzimit të së drejtës për qasje në drejtësi, të cilat, ndër të tjera, janë pasojë e infrastrukturës joadekuate ligjore dhe burimeve të kufizuara financiare të ndara për ndërgjegjësimin lidhur me këtë çështje dhe ofrimin e ndihmës juridike falas. Prandaj, është e nevojshme të tejkalohen

<sup>1</sup> Ligji nr. 04/l-017 për Ndhimë Juridike falas i vitit 2012, i plotësuar dhe ndryshuar nga Ligji i vitit 2022. Të qasëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2803>

këto sfida dhe të krijohet sistem gjithëpërfshirës, funksional dhe efikas i ndihmës juridike falas, i cili do të siguronte barazi në qasjen në drejtësi.

Duke marrë parasysh drejtimet strategjike të Republikës së Kosovës dhe përpjekjet e bëra nga shteti për vendosjen e plotë të sundimit të ligjit, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, që është parakusht për anëtarësim në Bashkimin Evropian, në sistemin e Ndihmës Juridike Falas deri më tani janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm por të pamjaftueshëm drejt krijimit të një sistemi të ndihmës juridike efektiv, efikas dhe financiarisht të qëndrueshëm, që plotëson nevojat e qytetarëve dhe kontribuon në vendosjen e shtetit ligjor dhe rendit juridik.

Kodi i Procedurës Penale i vitit 2022 (KPP) ofron detaje shumë specifike në lidhje me dhënien e ndihmës juridike penale (përmes “avokatit të caktuar” ose përfaqësimit sipas detyrës zyrtare përmes OAK paguar nga KPK dhe KGJK) dhe në cilat raste mbrojtja është “e detyrueshme” (që do të thotë se lëndat nuk mund të procedojë ligjërisht pa përfaqësim nga avokati mbrojtës) ose “jo e detyrueshme” (d.m.th., nga e drejta për avokat mbrojtës mund të hiqet dorë në lëndë të caktuara dhe lëndët e tilla mund të procedohen në gjykatë pa avokat mbrojtës).

Sipas nenit 52 (E drejta e të pandehurit për të pasur mbrojtës), i dyshuari dhe i pandehuri kanë të drejtë të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale. Para çdo marrjeje në pyetje të dyshuarit ose të pandehurit, policia ose organi tjetër kompetent, prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues udhëzon të dyshuarin ose të pandehurin për të drejtën e tij në angazhimin e mbrojtësit dhe që mbrojtësi mund të jetë prezent gjatë marrjes së tij në pyetje. Në rastet kur nuk parashihet mbrojtja e detyruar, nga e drejta për të pasur mbrojtës mund të hiqet dorë, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtën e tij në mbrojtje. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i dyshuari apo i pandehuri dhe nga organi kompetent që e zbaton procedurën, ose mund të bëhet gojarisht në audio apo videokasetë, autenticiteti i të cilës verifikohet nga gjykata. Personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet nuk mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës. Gjithashtu, personat të cilët tregojnë shenja të çrregullimeve ose të paaftësisë mendore nuk mund të heqin dorë nga e drejta në angazhimin e mbrojtësit. Kur i dyshuari ose i pandehuri i cili ka hequr dorë nga e drejta në angazhimin e mbrojtësit më vonë e kërkon sërish këtë të drejtë, ai këtë mund ta ushtrojë menjëherë.

Sipas nenit 53, për mbrojtës mund të angazhohet vetëm avokati i cili është anëtar i OAK. Neni 54 tutje parashikon se mbrojtësi nuk mund të mbrojtë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje, pavarësisht se a është bërë veçimi i procedurës apo fazës së procedurës.

Pastaj, sipas nenit 56 (Mbrojtja e detyruar), i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste të mbrojtjes së detyruar:

(1) nga marrja në pyetje për herë të parë e deri në përfundim të procedurës penale me vendim të formës së prerë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses;

(2) nga arrestimi, gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim;

(3) nga momenti i marrjes në pyetje për herën e parë për veprë penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim;

(4) në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm;

(5) në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë marrëveshje për pranimin e fajësisë; ose

(6) në të gjitha rastet kur i akuzuari gjykohet në mungesë sipas nenit 303 të KPP.

Në qoftë se i pandehuri në rastin e “mbrojtjes së detyruar” nuk angazhon mbrojtës, e angazhimin nuk e bën askush nga personat në nenin 52 paragrafi 7 të KPP-së, gjyqtari kompetent ose organi tjetër kompetent që e zbaton procedurën i cakton një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.

Aktualisht në sistem, nuk ka asnjë test të “mjeteve” për caktimin e avokatit mbrojtës në rastet e mbrojtjes së detyruar sipas nenit 56 të KPP-së, që do të thotë se edhe të pandehurit mund të marrin avokat mbrojtës falas të paguar nga shteti në lëndët që bien në kuadër të nenit 56. Përfshirja e një testi të mundësive financiare në kuadër të nenit 56 (ose zbatimi i detyrimit për të rimbursuar shtetin për kostot e ndihmës juridike nëse ndihma juridike falas u ofrohet të pandehurve që qëndrojnë mirë financiarisht) nuk do të shkelte në asnjë mënyrë të drejtën ndërkombëtare dhe në fakt do të ishte në përputhje me praktikën e mira në shumicën e vendeve të tjera të rajonit dhe botës me sisteme funksionale të ndihmës juridike.

Si rrjedhojë vlerësohet që Neni 56 të përfshij një kërkesë për “përshtatshmëri financiare” ose test të “mjeteve” dhe që ky test i mjeteve duhet të përcaktohet në të njëjtën mënyrë si përcaktohet përshtatshmëria financiare sipas Ligjit për Ndihmën Juridike Falas (“i përshtatshëm për ndihmë sociale”). Kjo do të standardizonte kriteret e përshtatshmërisë për të gjitha llojet e ndihmës juridike (penale, civile, administrative, etj.), që do të jetë veçanërisht e rëndësishme nëse përgjegjësia për pagesën dhe kontrollin e cilësisë për të gjitha format e ndihmës juridike të financuar nga shteti i transferohet ANJF-së, siç analizohet mëposhtë (që të ketë vetëm një pagues dhe një entitet kontrolli të cilësisë).

Siç do të shihet më poshtë kur diskutohet “universi” i rasteve penale të përshtatshme për ndihmë juridike penale të financuar nga shteti, vlerësohet se vendosja e këtij testi të

mjeteve financiare në nenin 56 do të zvogëlojë ndjeshëm numrin e përgjithshëm të të pandehurve të përshtatshëm për ndihmë juridike nga 6,072 raste në vit në 4,489, sipas analizave të bëra. Sipas analizës të kostos/përfitimit të paraqitur më poshtë, kjo do të zvogëlojë numrin e rasteve në 2,705 (bazuar në standardin e varfërisë së Bankës Botërore - të dhëna për përqindjen e personave të përshtatshëm sipas standardit të “ndihmës sociale” nuk ishin në dispozicion) me një kursim të mundshëm prej 1,114,460 euro (që mund të përdoren për raste të tjera penale (d.m.th., ato me një dënim maksimal mbi tre vite burg) që janë financiarisht të paaftë për të paguar për mbrojtje juridike sipas standardit të Ligjit për Ndihmën Juridike.

Duhet të theksohet se për të shmangur konfuzionin dhe çdo sfidë të ardhshme, mund të jetë e nevojshme të ndryshohet fjala “i detyrueshëm” në nenet 52 dhe 56 të KPP-së, në raste mbrojtjeje “me prioritet të lartë”, në të cilat gjyqtarët duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që i pandehuri penal të ketë vërtet përfaqësim (por të eliminohet ndalimi për të vazhduar procedurën penale pa përfaqësim). Në ato raste kur i pandehuri nuk i plotëson standardet e përshtatshmërisë financiare për përfaqësim të financuar nga shteti dhe nuk dëshiron të paguajë për përfaqësim ligjor në emër të tij apo të saj, gjyqtari duhet të vlerësojë me kujdes (ose të referojë një ekspert për të vlerësuar) gjendjen mendore të të pandehurit për t'u siguruar që ai ose ajo është me mendje të qartë dhe po merr vendimin për të refuzuar të ketë mbrojtje juridike dhe për të përfaqësuar veten e tij ose të saj, pas shqyrtimit të kujdesshëm. Nëse i pandehuri nuk është me mendje të qartë, duhet të ofrohet mbrojtje penale e financuar falas nga shteti. Duhet të theksohet gjithashtu se kushtëzimi i shërbimeve të mbrojtjes penale të financuar nga shteti me një test të mjeteve ose të përshtatshmërisë financiare është plotësisht në përputhje me të drejtën ndërkombëtare (shih më poshtë) dhe praktikat e mira dhe është plotësisht në përputhje me standardet e përcaktuara aktualisht në Ligjin për Ndihmën Juridike, që gjithashtu zbatohet për rastet penale. Bërja e këtij amendamenti do të eliminonte konfliktin e normave që ekziston aktualisht midis KPP-së dhe Ligjit për Ndihmën Juridike lidhur me përshtatshmërinë për ndihmën juridike penale.

Megjithatë, nëse ka shqetësime për mos ofrimin e ndihmës juridike falas të financuar nga shteti për të pandehurit në të gjitha rastet që bien nën klauzolat 1, 2, 4, 5 dhe/ose 6 të Nenit 56 të KPP-së aktual (d.m.th., në rastet kur i pandehuri është i paaftë, në paraburgim, i shurdhër, i pagojë, duke bërë një marrëveshje, gjykohet në mungesë, etj.), disa ose të gjitha këto mund të klasifikohen ende si raste mbrojtjeje “të detyrueshme”, me vetëm rastet e klauzolës 4 (ato me një dënim maksimal mbi pesë vite burg), që janë shumica e rasteve “të detyrueshme” aktualisht, mund të klasifikohen si “me prioritet të lartë”.

Sipas nenit 57 të KPP-së (Mbrojtësi me shpenzime publike kur mbrojtja nuk është e detyruar), kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes; dhe plotësohet një nga kushtet si në vijim: procedura penale zhvillohet për veprë penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim prej tre (3) apo më shumë vjet burgim; ose këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë

pavarësisht nga dënimi i paraparë. Para caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike sipas nenit 57, i pandehuri duhet të dorëzojë një deklaratë duke cekur pasuritë e tij dhe të deklarohet se nuk mund të përballojë shpenzimet e mbrojtësit. Në përputhje me nenin 11 të KPP-së, të pandehurit i caktohet mbrojtës i pavarur, me përvojë dhe me kompetencë në përputhje me llojin e veprës penale dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod.

Standardi i përshtatshmërisë financiare për ndihmë juridike falas në rastet e mbrojtjes jo të detyrueshme nuk është përcaktuar dhe hulumtimet tona tregojnë se gjyqtarët rrallëherë kërkojnë deklaratën nga Neni 57. Si rrjedhojë, konsiderohet i nevojshëm ndryshimi i Nenit 57 të KPP-së, për të siguruar që standardi i përshtatshmërisë financiare për ndihmë juridike falas të financuar nga shteti është i njëjti standard si ai sipas Ligjit për Ndihmën Juridike (“i përshtatshëm për ndihmë sociale”). Kjo do të lehtësojë emërimin e mbrojtësve në rastet penale (d.m.th., nga gjyqtarët, ose duke kontaktuar paraprakisht ANJF për të bërë një përcaktim të shpejtë të përshtatshmërisë financiare si një hap në procesin e emërimit, ose duke hyrë drejtpërdrejt në bazat kombëtare të të dhënave që ANJF aktualisht po negocion për sistemin e ndjekjes së rasteve).

Disa vende në Evropë kanë dispozita për mbrojtje juridike të detyrueshme në procedurat penale, duke siguruar që individët e akuzuar për vepra penale të kenë qasje në përfaqësim juridik. Megjithatë, shumica e vendeve e kanë të paraparë standardin e përshtatshmërisë financiare të të pandehurit në mënyrë që ai/ajo të jetë përfitues i ndihmës juridike të siguruar me mjete financiare të shtetit. Disa nga këto vende të analizuar, janë përfshirë në tabelën e mëposhtme:

| Shteti               | Rregullimi i mbrojtjes së detyrueshme në Kodet e Procedurës Penale   | Standardi i kriterit financiar |
|----------------------|--|--------------------------------|
| Gjermania            | Përfaqësimi juridik është i detyrueshëm në rastet e rënda penale, veçanërisht nëse i akuzuari përballlet me dënime të rënda ose nëse çështja përfshin çështje komplekse ligjore.                                 | Jo                             |
| Italia               | Italia kërkon mbrojtje juridike në procedurat penale. Nëse i akuzuari nuk ka mundësi të paguajë një avokat, shteti e siguron një të tillë.   | Po                             |
| Spanja               | Mbrojtja juridike është e detyrueshme në procedurat penale në Spanjë. Nëse i pandehuri nuk ka mundësi të paguajë një avokat, shteti e siguron një të tillë.  | Po                             |
| Mbretëria e Bashkuar | Në Mbretërinë e Bashkuar, të pandehurit kanë të drejtën për përfaqësim juridik. Për veprat e rënda, ndihma juridike është e disponueshme për të siguruar përfaqësim për ata që nuk kanë mundësi ta paguajnë atë. | Po                             |

|         |   |    |
|---------|---|----|
| Franca: | Në Francë, të pandehurit duhet të kenë përfaqësim juridik gjatë gjykimeve penale, veçanërisht në rastet më të rënda. Nëse i akuzuari nuk ka mundësi të paguajë një avokat, do t'i caktohet një i tillë. | Po |
|---------|---|----|

Ngjashëm edhe në shumicën e shteteve të rajonit, përjashtimisht Mali i Zi, përshtatshmëria financiare është parakusht që të pandehurit të përfitojnë ndihmë juridike nga shteti në rastet e mbrojtjes së detyrueshme. Tabela e mëposhtme ilustron rregullimin në shtetet e rajonit:

| Shteti    | Rregullimi i mbrojtjes së detyrueshme në Kodet e Procedurës Penale  | Standardi i kriterit financiar |
|-----------|---|--------------------------------|
| Shqipëria | <p><b>E drejta për mbrojtje</b><br/> <b>Neni 12</b></p> <p>(1) I pandehuri ka të drejtë të mbrohet ose me ndihmën profesionale të mbrojtësit që e zgjedh nga mesi i avokatëve.<br/> (2) I pandehuri ka të drejtë që në seancën e tij të ketë mbrojtës.<br/> (3) Para seancës së parë, i pandehuri njoftohet për të drejtën që të angazhojë mbrojtës, të pajtohet me mbrojtësin për mënyrën e mbrojtjes dhe se mbrojtësi mund të marrë pjesë në seancën e tij. Ai do të paralajmërohet se çdo gjë që ai thotë mund të përdoret kundër tij si provë.<br/> (4) Nëse vetë i pandehuri nuk merr mbrojtës, do t'i caktohet mbrojtës sipas detyrës zyrtare, kur kjo është e përcaktuar me këtë Kod.<br/> (5) Të pandehurit duhet t'i sigurohet kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.<br/> (6) I dyshuari ka të drejtë për mbrojtës në pajtim me këtë Kod.</p> | Po                             |
| Kroacia   | <p><b>Neni 5</b><br/> <b>Parimet e Procedurës Penale</b></p> <p>(1) I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën profesionale të një avokati mbrojtës që zgjedh nga radhët e avokatëve. Nëse ai nuk angazhon vetë një avokat mbrojtës, i pandehurit do t'i caktohet një avokat mbrojtës për të siguruar mbrojtjen e tij kur kjo përcaktohet nga ky Ligj.<br/> (2) Në kushtet e përcaktuara nga ky Ligj, një i pandehur që nuk mund të paguajë shpenzimet e një avokati mbrojtës, me kërkesën e tij, do t'i caktohet një avokat mbrojtës me shpenzimet e fondeve të buxhetit.</p>   | Po                             |

|                  |   |    |
|------------------|---|----|
|                  | <p>(3) Gjykata ose organi tjetër shtetëror që kryen veprime në procedurat penale duhet, para se të marrë në pyetje të pandehurin, ta informojë atë për të drejtën për një avokat mbrojtës dhe në lidhje me një avokat mbrojtës.</p> <p>(4) I pandehuri duhet të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.</p>   |    |
| <b>Mali i Zi</b> | <p><b>Neni 12: E drejta për mbrojtje</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën profesionale të një avokati mbrojtës që zgjedh nga radhët e avokatëve.</li> <li>2. I pandehuri ka të drejtë të ketë një avokat mbrojtës të pranishëm në seancën e tij.</li> <li>3. Para seancës së parë, i pandehuri duhet të informohet për të drejtën për të marrë një avokat mbrojtës, të drejtën për të rënë dakord me avokatin mbrojtës për metodën e mbrojtjes dhe të drejtën që avokati mbrojtës të marrë pjesë në seancën e tij. I pandehuri do të njoftohet se çdo gjë që thotë mund të përdoret kundër tij si provë.</li> <li>4. Nëse i pandehuri nuk zgjedh një avokat mbrojtës, do t'i caktohet një avokat mbrojtës ex officio kur kjo përcaktohet nga ky Kod.</li> <li>5. I pandehuri duhet të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.</li> <li>6. I dyshuari ka të drejtë për një avokat mbrojtës në përputhje me këtë Kod.</li> </ol> | Jo |

### 1.3. Vlerësimi i gjendjes aktuale lidhur me ofrimin e ndihmës juridike në Kosovë

Koncept Dokumenti ka realizuar në tërësi gjendjen aktuale të Ndhmës Juridike falas në Kosovë. Përmes këtij vlerësimi pasqyrohen në hollësi sfidat, problemet, synimet dhe mundësit e ndryshimit të gjendjes aktuale me qëllim të reformimit dhe avancimit. Për të vlerësuar gjendjen aktuale në lidhje me ofrimin e ndihmës juridike në Kosovë në të gjitha fushat relevante (çështje civile, administrative, penale, kundërvajtëse – shkelje më të lehta), janë shqyrtuar tri aspekte kyçe, përkatësisht: **volumi i ndihmës juridike, cilësia e ndihmës juridike dhe mekanizmat e financimit të ndihmës juridike që ofrohet**

**aktualisht. Duke u trajtuar këto pjesë, do të mundësohet të identifikohen mangësitë dhe sfidat për të dhënë më pas rekomandime për adresimin e tyre.**

### 1.3.1 Volumi i ndihmës juridike të financuar nga shteti

Dy aspekte të volumit të ndihmës juridike falas janë trajtuar si në vijim: (1) volumi i ndihmës juridike që ofrohet aktualisht; dhe (2) volumi i ndihmës juridike që do të duhej të ofrohet/të vihet në dispozicion për të përmbushur kërkesat e të gjithë qytetarëve që kualifikohen për ndihmë juridike falas. Më poshtë paraqitet kosto e kësaj ndihme juridike dhe mënyra se si financohet.

#### Sasia e ndihmës juridike të financuar nga shteti që ofrohet aktualisht:

Për qëllime të këtij Koncept Dokumenti është analizuar ndihma juridike e financuar nga shteti, kështu që do të paraqiten të dhënat lidhur me vetëm dy ofruesit e parë të ndihmës juridike, përkatësisht ANJF dhe sistemin për caktimin *sipas detyrës zyrtare* nga OAK (me financim përmes KPK dhe KGJK). Për bazë janë marrë kryesisht të dhënat nga 2 vitet e fundit - 2022 dhe 2023, viti i fundit përfaqësues i plotë dhe viti i parë pas pandemisë së COVID-19. Të dhënat nga 2020 dhe 2021 nuk janë përfaqësuese për shkak të veprimtarisë së kufizuar në gjykata dhe institucioneve të tjera për shkak të masave kundër pandemisë.

Ndihma juridike falas i ofrohet të gjithë personave që plotësojnë disa kritere specifike. Së pari, ekziston kriteri kualifikues, që përcakton se kush ka të drejtë të përfitojë nga ndihma juridike falas. Kjo përfshin shtetasit e Republikës së Kosovës me vendbanim në territorin e saj, personat me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës, personat e tjerë të përcaktuar me ligj apo rregullat e të drejtës ndërkombëtare që obligojnë Republikën e Kosovës, si dhe personat që përfitojnë ndihmë juridike falas në bazë të reciprocitetit. Sipas zyrtarëve të ANJF, në praktikë janë paraqitur sfida në vlerësimin e këtij kriteri, andaj, është e nevojshme një specifikim më i detajuar në mënyrë që të ketë një aplikim uniform të vlerësimit të kriterit kualifikues, duhet të reflektohet mbi shpenzimet procedurale në përgjithësi dhe në veçanti shërbimet e përkthimit lidhur me përfaqësimin e azil kërkesve dhe personave që kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare.

Së dyti, kriteri financiar vlerëson situatën financiare të aplikuesit për të përcaktuar nëse ai ose ajo kualifikohet për ndihmë juridike falas. Kjo ndihmë ndahet në ndihmë juridike primare dhe sekondare. Ndihma juridike primare i ofrohet personave që përfitojnë ndihmë sociale ose janë në situatë të ngjashme me ata që përfitojnë ndihmë sociale. Ndihma juridike sekondare u ofrohet personave me të ardhura familjare më të ulëta se të ardhurat mesatare familjare. Sipas zyrtarëve të ANJF, në praktikë janë paraqitur sfida në vlerësimin edhe të këtij kriteri, që gjithashtu kërkon specifikim.

Së fundi, kriteri juridik vlerëson bazueshmërinë e kërkesës juridike të aplikuesit për të përcaktuar nëse ndihma juridike është e justifikuar. Ky kriter përfshin vlerësimin e vlerës reale të kërkesës, fuqisë argumentuese të provave të prezantuara nga kërkuesi, dhe



mundësisë së suksesit të kërkesës. Edhe ky kriter ka nevojë për specifikim të mëtutjeshëm.

Pavarësisht nga kriteret e përcaktuara për ndihmë juridike falas, disa grupe specifike kanë të drejtë për këtë ndihmë në mënyrë automatike të pakushtëzuar. Këta përfitues përfshijnë personat e dhunuar seksualisht gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999, viktimat e dhunës në familje, si dhe viktimat dëshmitare të dhunës që janë në varësinë e viktimave të dhunës në familje. Gjithashtu, viktimat e dhunës në baza gjinore, viktimat e cilitdo lloji të dhunës seksuale, përfshirë ngacmimin seksual, dhe viktimat e trafikimit me qenie njerëzore kanë të drejtë për ndihmë juridike falas.

Ndihma juridike falas i ofrohet në mënyrë të pakushtëzuar edhe viktimave të mitur, fëmijëve që jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, dhe fëmijëve nën kujdestari që kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor. Personat të cilëve u është cenuar e drejta për shkak të diskriminimit, bazuar në vendimin e organit kompetent sipas ligjit në fuqi për mbrojtje nga diskriminimi, gjithashtu gëzojnë të drejtën e pakushtëzuar në ndihmë juridike falas. Për më tepër, gazetarët, gazetarët e pavarur, fotoreporterët, kameramanët dhe redaktorët që punojnë në ose për media të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media dhe/ose në media anëtare në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës kanë poashtu këtë të drejtë.

Sipas zyrtarëve të ANJF, në praktikë janë paraqitur sfida në vlerësimin e kriterëve për të qenë pjesë e kategorive të lartpërmendura. Këto kategori rrjedhimisht duhet të rishikohen dhe detajizohen tutje, por edhe të shtohen kategori të reja siç janë viktimat e luftës apo edhe kategori tjera bazuar në nevojën për ndihmë juridike falas.

**Agjencia për Ndihmë Juridike Falas:** ANJF ofron dy lloje të ndihmës juridike: (1) ndihmë juridike primare (që ofrohet kryesisht nga avokatë të caktuar nga OAK dhe të paguar nga ANJF sipas modelit të mbrojtësit të caktuar (MMC); dhe (2) ndihmë juridike sekondare (që ofrohet kryesisht nga “zyrtarë ligjorë” me orar të plotë, të punësuar ekskluzivisht për këtë qëllim, që janë juristë por pa provim të jurisprudencës.

Ngjashëm me vlerësimin e kriterëve, edhe në vlerësimin e llojeve të ndihmës juridike primare dhe sekondare janë paraqitur probleme në praktikë. Kështu, sipas ligjit aktual, të dyja llojet e ndihmës juridike kanë për qëllim të sigurojnë që individët që kanë nevojë për ndihmë juridike të kenë qasje në informata, këshilla dhe përfaqësim ligjor. Përderisa, do të duhej të ishte një ndarje më e qartë.

Pra ndihma primare të përfshijë informata dhe këshilla, ndërsa sekondarja të përfshijë informata, këshilla, përpilim të shkresave dhe përfaqësim ligjor. Për sa i përket shërbimeve nga grupi i parë, ANJF ka në dispozicion të dhënat e mëposhtme për rastet që u janë caktuar avokatëve të OAK:

| VITI          | CIVILE       | ADMINISTRATIVE | PENALE    | KUNDËRVAJTËSE | TOTALI       |
|---------------|--------------|----------------|-----------|---------------|--------------|
| 2023          | 464          | 11             | 25        | 0             | 500          |
| 2022          | 505          | 19             | 31        | 0             | 555          |
| 2021          | 426          | 22             | 21        | 0             | 469          |
| 2020          | 318          | 1              | 14        | 1             | 334          |
| 2019          | 261          | 2              | 2         | 0             | 265          |
| 2018          | 281          | 1              | 2         | 0             | 284          |
| 2017          | 326          | 2              | 3         | 0             | 331          |
| <b>TOTALI</b> | <b>2,581</b> | <b>58</b>      | <b>98</b> | <b>1</b>      | <b>2,738</b> |

Siç shihet, pjesa dërrmuese (mesatarisht 2,581/2,738 ose 94%) nga grupi i parë është ofruar në çështje civile (që përfshinë çështjet pronësore, familjare, trashëgimore dhe detyrimore) dhe fare pak ndihmë të ofruar qoftë në çështje administrative ose penale/kundërvajtje.

Për sa i përket të gjitha shërbimeve/rasteve të trajtuara nga ANJF gjatë vitit 2022 dhe deri në nëntor të vitit 2023 kemi:

| LËMIA/ GJINIA | Civile | Administrative | Penale | Kundërvajtëse | M    | F    | Total |
|---------------|--------|----------------|--------|---------------|------|------|-------|
| TOTAL         | 3906   | 6853           | 546    | 104           | 6156 | 5253 | 11409 |

Lidhur me ndihmën juridike që nuk përfshijnë përfaqësim ligjor në gjykatë, sasia e ndihmës së ofruar është dukshëm më e lartë. Pra, kjo ndihmë është ofruar nga stafi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas:

Nga numri total i të punësuarve në cilësinë e shërbyesve civil në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas është 36 (tridhjetë e gjashtë), nga ta 22 (njëzetë e dy) janë femra dhe 14 (katërmëdhjetë) meshkuj. Sa i përket përqindjes: 61.11 % të punësuarja janë femra dhe 38.89 % janë meshkuj.

| <b>GJINIA</b>                  |                |
|--------------------------------|----------------|
| <b>FEMRA</b>                   | <b>MESHKUJ</b> |
| <b>22</b>                      | <b>14</b>      |
| <b>GJINIA PËRQINDJE</b>        |                |
| <b>61.11 %</b>                 | <b>38.89 %</b> |
| <b>Gjithsej 36 të punësuar</b> |                |

Sa i përket pozitave udhëheqëse, në nivelin e lartë drejtues udhëheq femër, në nivelin e mesëm drejtues udhëheq mashkull dhe në nivelin e ulët drejtues udhëheq mashkull.

Shifrat e ANJF-së për vitin 2022 si dhe për vitin 2023 (deri në nëntor kur është zhvilluar analiza për këtë Koncept Dokument), në lidhje me numrin e veprimeve të ndihmës juridike të ofruara nga zyrtarët ligjorë të ANJF-së të zbërthyer sipas çështjes lëndore dhe llojit të çështjes juridike janë:

#### **LËNDË CIVILE**

| <b>Lloji i çështjes juridike</b>             | <b>Numri i veprimeve të ofruara të NJF - 2022</b> | <b>Numri i veprimeve të ofruara të NJF - deri nëntor 2023</b> |
|--|---|---|
| <b>Çështje familjare</b>                     | 436   | 647   |
| <b>Çështje pronësore</b>                     | 227   | 243   |
| <b>Çështje të detyrimeve</b>                 | 310   | 289   |
| <b>Çështje ekzekutimi</b>                    | 257   | 290   |
| <b>Çështje të punës</b>                      | 136   | 136   |
| <b>Çështje të procedurës jo-kontestimore</b> | 79  | 87  |
| <b>Çështje të dhunës në familje</b>          | 36  | 59  |
| <b>Numri i përgjithshëm i lëndëve civile</b> | <b>1,483</b>                                      | <b>1,753</b>  |

## LËNDË ADMINISTRATIVE

| Lloji i çështjes juridike                            | Numri i veprimeve të ofruara të NJF - 2022 | Numri i veprimeve të ofruara të NJF - deri Nëntor 2023 |
|--|--|--|
| Çështje sociale                                      | 1323                                       | 1214   |
| Pensionet  | 1846                                       | 1903   |
| Çështje të tjera administrative                      | 417  | 309  |
| <b>Numri i përgjithshëm i lëndëve administrative</b> | <b>3,586</b>                               | <b>3,426</b>   |

## LËNDË PENALE

| Lloji i çështjes juridike                              | Numri i veprimeve të ofruara të NJF - 2022 | Numri i veprimeve të ofruara të NJF - deri Nëntor 2023 |
|--|--|--|
| Çështje penale   | 174  | 195  |
| Drejtësia për të mitur (sipas procedurës për të mitur) | 9  | 8  |
| Dhuna në familje                                       | 54   | 54   |
| <b>Numri i përgjithshëm i lëndëve penale</b>           | <b>241</b>                                 | <b>259</b>   |

## KUNDËRVAJTËSE

| Lloji i çështjes juridike | Numri i veprimeve të ofruara të NJF - 2022 | Numri i veprimeve të ofruara të NJF - deri Nëntor 2023 |
|---------------------------|--|--|
| Prishje e rendit publik   | 12   | 8  |
| Shkelje në trafik         | 51   | 38   |

|   |    |    |
|---|----|----|
| Numri i përgjithshëm i lëndëve të kundërvajtjes | 63 | 46 |
|---|----|----|

Numri i përgjithshëm i veprimeve juridike që janë ndërmarrë nga zyrtarët ligjorë të ANJF-së në të gjitha kategoritë në vitin 2022 ishte **5,373** dhe deri në Nëntor 2023 ishte **5,484**. Ndër llojet e veprimeve juridike që janë ndërmarrë përfshihen: këshilla juridike, përgatitja e padisë, hartimi i propozimeve, hartimi i ankesave në procedurë civile dhe administrative, kundërshtimet, shtjellimi i kërkesave, hartimi i kallëzimeve penale, hartimi i refuzimeve, apo referimi në institucione tjera, dhe të tjera. Sipas analizës së bërë, nëse personat që kërkojnë ndihmë juridike plotësojnë të gjitha kriteret kualifikuese, financiare, materiale ("interesat e drejtësisë"), atyre pothuajse gjithmonë u ofrohet nivel i caktuar i shërbimit, me fjalë tjera, ANJF i plotëson të gjitha kërkesat për shërbime juridike nga grupi i dytë dhe nuk ka qenë e detyruar të refuzojë shërbimet për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm.

#### Volumi aktual i ndihmës juridike penale të ofruar sipas detyrës zyrtare:


Sipas statistikave të vitit **2022** nga OAK, për rastet e ndihmës juridike (përfshirë ato përmes ANJF-së) janë caktuar avokatë si në vijim:

- Total caktime sipas detyrës zyrtare për ndihmë juridike (në çështje civile, administrative dhe penale) në vitin 2022: **10,059**
- Caktime sipas detyrës zyrtare për ndihmë juridike penale në gjykata (të paguara përmes KGJK): **1,933**
- Caktime sipas detyrës zyrtare për ndihmë juridike penale në prokurori (të paguara përmes KPK): **1,096**
- Caktime sipas detyrës zyrtare për ndihmë juridike penale në stacionet policore të Kosovës (të paguara përmes KPK): **4,912**
- Caktime për ndihmë juridike nga OAK në çështje civile, administrative dhe penale (të angazhuara dhe paguara përmes ANJF): **555**
- Angazhim *pro bono* i avokatëve në çështje civile: **53**
- Mos përmbushje të detyrimeve të avokatëve në caktimet sipas detyrës zyrtare: **280**
- Refuzime për t'u angazhuar si avokatë të ndihmës juridike në çështje civile: **1,226**

Duke qenë se në disa raste, mund të bëhen disa caktime sipas detyrës zyrtare në çështje penale (nganjëherë me të njëjtin avokat, por zakonisht me avokat të ndryshëm) në faza të ndryshme procedurale të çështjes (d.m.th., një avokat i caktuar në stacion të policisë, një

tjetër në zyrën e prokurorit, një ose disa tjetër në gjykata në shkallë të parë, dhe një tjetër në shkallë të dytë), disa nga shifrat mund të jenë për të njëjtin të pandehur në të njëjtën lëndë (dhe si i tillë, numri i “lëndëve” nuk pasqyron gjendjen reale). Megjithatë, OAK konfirmon se janë duke bërë përpjekje të nxisin akterët e sektorit të drejtësisë përgjatë zinxhirit procedural që të pyesin të pandehurin nëse i është caktuar më parë për të përfaqësuar të dyshuarin/të pandehurin, në mënyrë që të sugjerohet caktimi i të njëjtit avokat (për të siguruar vazhdimësinë e përfaqësimit).

Grafiku i mëposhtëm nga Raporti i OSBE-së për Ndihmën Juridike tregon, për qëllime krahasuese, tregon numrin e caktimeve sipas detyrës zyrtare për ofrimin e ndihmës juridike nga OAK në vitet 2019-2021:



### **Volumi i ndihmës juridike të nevojshme për plotësimin e kërkesës aktuale:**

Ajo që është e qartë është se nuk përmbushen plotësisht nevojat për ndihmë juridike falas, qoftë sipas legjislacionit vendor ose sipas të drejtës ndërkombëtare. Për qëllime të këtij Koncept Dokumenti, do të përdoret viti i fundit i plotë (2022) si burim kryesor i të dhënave për përcaktimin e mangësive dhe sfidave dhe për të ndërmarrë analizën kosto/përfitim të opsioneve për plotësimin/përmbushjen e tyre. Vitet 2020 dhe 2021, siç u theksua më lartë, ishin “jonormale” për shkak të pandemisë së COVID-19 dhe së këndejmi përdorimi i tyre këtu mund të shtrembërojë realitetin.

Për të përcaktuar “nevojën” ose “kërkesën” aktuale për ndihmë juridike në mënyrë që ta krahasojmë atë me volumin aktual të ndihmës juridike që ofrohet (siç është paraqitur më

lartë), duhet të përcaktohet “gjithësia” e lëndëve në të cilat paditësi (në çështjet civile ose administrative) ose i pandehuri (në çështjet penale) ka të ngjarë të plotësojë kriteret për ndihmë juridike falas. Kjo është bërë duke përdorur standardet e pranueshmërisë (kualifikimit për ndihmë juridike falas) sipas legjislacionit të Kosovës (LNJFF dhe KPP) si dhe sipas të drejtës ndërkombëtare (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata e të Drejtave të Njeriut).

### **Tërësia e lëndëve të pranueshme për ndihmë juridike sipas legjislacionit të Kosovës:**

Përcaktimi i ‘gjithësisë’ së nevojës për ndihmë juridike nuk është e thjeshtë pasi disa prej kriterëve kualifikues mund të jenë subjektivë (siç është standardi “interesat e drejtësisë” në lëndët e ndihmës juridike në çështje civile), që nuk mund të konstatohen lehtësisht pa iu nënshtruar një analize të detajuar rast pas rasti. Megjithatë, është bërë përpjekje për të mbledhur të dhënat nga institucionet e ndryshme të sektorit të drejtësisë.

Në përgjithësi, sipas statistikave të pjesshme nga KGJK për vitin 2022:

- Numri i lëndëve të reja penale të paraqitura në gjykatat themelore të Kosovës në nivel kombëtar në vitin 2022 është 14,636 (Janar-Shtator 2022) të cilat, duke u krahasuar me pjesë tjetër të vitit, do të barazoheshin me përafërsisht **19,515** për të gjithë vitin 2022.
- Numri i lëndëve të reja civile të paraqitura në gjykatat themelore në nivel kombëtar në vitin 2022 është 31,121 (Janar-Shtator 2022), të cilat, duke u krahasuar me pjesën tjetër të vitit, do të barazoheshin me përafërsisht **41,495** për të gjithë vitin 2022.
- Numri i lëndëve të reja administrative të paraqitura në Departamentin për çështje Administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës në vitin 2022 është 2,188 (Janar-Shtator 2022), të cilat, duke u krahasuar me pjesën tjetër të vitit, do të barazoheshin me përafërsisht **2,915** për të gjithë vitin 2022.

### **Çështjet e së drejtës civile dhe administrative:**

Përcaktimi i ‘gjithësisë’ së nevojës për ndihmë juridike në çështjet e së drejtës civile dhe administrative gjithashtu nuk është i lehtë, pasi që nuk mbahen statistika në lidhje me këto çështje. Këtu supozojmë se standardi i pranueshmërisë, qoftë sipas LNJFF ashtu edhe sipas të drejtës ndërkombëtare, do të ishte afërsisht i njëjtë – pamundësia financiare për të paguar avokatin (testi i mundësive financiare) dhe interesat e drejtësisë (testi i themelësisë së lëndës). Përsëri, është përdorur viti 2022 si vit bazë më përfaqësues. Kishte gjithsej **41,495** lëndë të reja civile që janë paraqitur në sistemin gjyqësor në Kosovë në vitin 2022. Duke aplikuar normën e nivelit të varfërisë sipas Bankës Botërore prej 23% në vitin 2022, kjo do të thotë se nga këto 41,495 lëndë të vlerësuara, përafërsisht **9,453** të paditësve do të kualifikoheshin për ndihmë juridike sipas kriterëve të LNJFF ose sipas kriterëve të së drejtës ndërkombëtare (të cilat janë në thelb të njëjta).

Në të drejtën administrative, aplikohet standard më i lartë për pranueshmërinë/plotësimin të kriterëve për t'u kualifikuar për ndihmë juridike falas, duke pasur parasysh faktin se mbi 50% e çështjeve të së drejtës administrative kanë të bëjnë me pensionet dhe përfitimet sociale, dhe sipas përkufizimit, personat që aplikojnë dhe kanë probleme ligjore me pensionet dhe përfitimet sociale janë me burime të ulëta financiare. Së këndejmi, është aplikuar standardi 50% për pranueshmërinë. Duke qenë se kishte rreth 2,915 lëndë të reja të së drejtës administrative në vitin 2022, ANJF vlerëson se në përafërsisht **1,458** prej tyre, paditësi (kërkuesi) do të ishte i pranueshëm për ndihmë juridike.

Për sa i përket ndihmës juridike sekondare në çështjet civile dhe administrative, 'gjithësia' e nevojës ose kërkesa për shërbime të tilla është praktikisht e pamundur të përcaktohet në mënyrë sasiore dhe do të varet kryesisht nga niveli i shpërndarjes së shërbimeve nga ANJF dhe mënyra e qasjes në to.

### Çështjet penale:

Të dhënat në vijim janë të gjeneruar përmes sistemit SMIL në KGJK:

- Numri total i dënimeve në 2022 të shqiptuara nga sistemi i drejtësisë penale ishte **15,808**
- Numri i dënimeve në vitin 2022 për lëndët me të paktën një akuzë për vepër penale me "mbrojtje të detyruar" ishte **2,802** (të dhënat nuk ishin të disponueshme në formë të zbërthyer për numrin e aktakuzave për vepra penale ku parashikohet mbrojtja e detyruar, që do të ishte e dobishme për të vlerësuar gjithësinë e nevojës)
- Numri i dënimeve në vitin 2022 për lëndët me të paktën një akuzë për vepër penale kur "mbrojtja nuk është e detyruar" ishte **9,019**
- Numri i dënimeve në 2022 për vepra penale më pak të rënda (dënim maksimal më pak se tre vjet) dhe lëndë të tjera penale ishte **3,987**

Këto statistika janë proporcionalisht në përputhje me tre vitet e mëparshme (me përjashtim të vitit 2020) dhe me vitin 2023 deri më sot:

|                               | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 |
|-------------------------------|------|------|------|------|------|
| Mbrojtja e detyruar           | 315  | 1414 | 2323 | 2802 | 2217 |
| Mbrojtja nuk është e detyruar | 1639 | 5551 | 8308 | 9019 | 6913 |



Në lidhje me aktakuzat, nga KPK janë marrë këto të dhëna:

- Numri i personave të akuzuar në vitin 2022 nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë (i cili trajton lëndët me krime me dënim maksimal deri në 10 vjet) i Gjykatave Themelore ishte **5,585** (disa nga këto lëndë do të ishin çështje me mbrojtje të detyruar dhe të tjerat çështje kur “mbrojtje nuk është e detyruar” ose çështje më pak të rënda sipas KPP – të dhënat e ofruara nuk ishin të zbërthyer sipas veprës penale ose seriozitetit të veprës penale);
- Numri i personave të akuzuar në vitin 2022 nga Departamenti i Krimeve të Rënda (i cili trajton lëndët me krime që dënohen më shumë se 10 vjet burgim maksimal) i Gjykatave Themelore: **2,407** (të gjitha këto janë çështje me “mbrojtje të detyruar” sipas KPP);
- Numri i personave të akuzuar në vitin 2022 nga Prokuroria Speciale ishte **144** (këto supozohet se të gjitha do të ishin çështje me “mbrojtje të detyruar” sipas KPP); dhe
- Numri i të miturve të akuzuar nga Departamenti për të Mitur i Prokurorisë në vitin 2022 ishte **1,443** (këto lëndë do të ishin çështje me mbrojtje të detyruar sipas KPP).
- Grafiku i mëposhtëm nga Raporti i OSBE-së për Ndihmën Juridike ilustron përgjigjet nga gjyqtarët dhe prokurorët e anketuar në lidhje me frekuencën e kufizuar të caktimeve sipas detyrës zyrtare për përfaqësim përmes ndihmës juridike penale kur mbrojtja nuk është e detyruar (d.m.th., me dënim maksimal nga tre deri në pesë vjet dhe vini re se kjo ishte përpara ndryshimeve në KPP për uljen e kufijve të pranueshmërisë për mbrojtje sipas detyrës zyrtare):





Figura 1. Shpeshtësia ex-officio në rastet e mbrojtjes së pa detyrueshme e raportuar nga gjyqtarët dhe prokurorët



Për këtë arsye (pra, që gjyqtarët vërtet caktojnë të paktën një minimum të ndihmës juridike kur “mbrojtja nuk është e detyruar”), andaj supozohet se për qëllimet e këtij Koncept Dokumenti sasia e ndihmës juridike të caktuar kur “mbrojtja nuk është e detyrueshme” është shumë e vogël por ekziston dhe do të vlerësohet se ofrohet në 15% të totalit të lëndëve.

### 1.3.2 Sfidat dhe mangësitë lidhur me volumin e ndihmës juridike

Çështjet e së drejtës civile dhe administrative: Në fushën e së drejtës civile/ administrative ka mangësi të ndjeshme në kërkesën për ndihmë juridike (veçanërisht për përfaqësimin nga avokatët në gjykatë) dhe ofertën e ndihmës juridike, ndonëse sërish kjo e vështirë të vlerësohet në mënyrë sasiore, edhe më shumë se në fushën penale, pasi aty janë disa elemente diskrecionare (d.m.th., mundësia e suksesit në themelet e çështjes) që, për shembull, nuk janë të pranishme në lidhje me çështjet penale (ku e drejta për avokat mbrojtës është më e gjerë).

Mangësia (hendeku) në mbulim, përkatësisht diferenca ndërmjet 'gjithësisë' së paditësve të pranueshëm për ndihmë juridike në çështje civile (duke përfshirë edhe çështjet familjare, pronësore dhe trashëgimore) dhe volumit të ndihmës juridike të ofruar realisht nga shteti është shumë e madhe, duke arritur në **8,948 individë** (9,453 minus 505), me vetëm **5.3%** nga ata që kanë të ngjarë të jenë të pranueshëm për ndihmë juridike që në fakt marrin ndihmë juridike.

Mangësia (hendeku) në mbulim, përkatësisht diferenca ndërmjet 'gjithësisë' së paditësve të pranueshëm për ndihmë juridike në çështje administrative dhe sasisë së ndihmës juridike të ofruar realisht nga shteti është edhe më e madhe duke arritur në **1,439 individë** (1,458 minus 19), me vetëm **1.3%** nga ata që kanë të ngjarë të jenë të pranueshëm për ndihmë juridike që në fakt marrin ndihmë juridike. Në mënyrë të ngjashme, vlen të theksohet se këtu po i referohemi vetëm ndihmës juridike në çështje administrative në formën e *përfaqësimit në gjykatë*. Siç u tha më lart, duket se ANJF rrallë refuzon të ofrojë shërbime të ndihmës juridike nga grupi i dytë i shërbimeve të ofruara nga zyrtarët e ANJF. Së këndejmi, ndryshe nga ndihma juridike e ofruar përmes angazhimit të avokatëve në të gjitha llojet e çështjeve, nuk duket të ketë mangësi të ndjeshme dhe të dukshme në mënyrë evidente për sa i përket ofrimit të ndihmës juridike nga ana e zyrtareve të ANJF-se në çështje jo-penale.

**Çështjet e së drejtës penale:** Përkitazi me volumin e ndihmës juridike në çështjet penale, deri tani deficiti më i madh është, sipas KPP, për të pandehurit që nuk janë në gjendje financiarisht të paguajnë avokatët kur "mbrojtja nuk është e detyruar" (domethënë, me dënim maksimal ndërmjet tre (3) dhe pesë (5) vjet) dhe sipas LNJJF dhe së drejtës ndërkombëtare, për të pandehurit në çështjet penale më pak të rënda (d.m.th., me dënim maksimal me burg prej më pak se tre (3) vjet ose në rastet penale të lehta (kundërvajtje). Përderisa nuk ka informata të mjaftueshme statistikor nga KGJK ose KPK për të përcaktuar saktësisht numrin e lëndëve në këto kategori, pasi as SMIL dhe as sistemi i përcjelljes së rasteve në PK nuk i ndjekin rastet të zbërthyera sipas këtyre kritereve, mund të vlerësohet, duke përdorur 2022 si viti bazë më i mirë, që janë afërsisht 16,002 lëndë (82% e totalit prej 19,515 gjithsej lëndë të reja) në kategoritë ku mbrojtja nuk është e detyruar dhe janë më pak të rënda/kundërvajtje. Kjo bazohet në të dhënat nga SMIL në lidhje me përqindjen e dënimeve në vitin 2022 kur mbrojtja është e detyruar, mbrojtja nuk

është e detyruar, si dhe në rastet më pak të rënda dhe të tjera, siç janë parashtruar më lartë. Kjo është në përputhje me përqindjen mesatare 5-vjeçare prej 18% nga viti 2019 në 2023, të dënimeve në rastet kur mbrojtja është e detyruar kundrejt atyre kur mbrojtja nuk është e detyruar, siç aplikohet për numrin total të vlerësuar të lëndëve (19,515) si dhe duke i krahasuar këto me numrin e përgjithshëm të dënimeve në vitin 2022 (15,808). Prandaj, mund të supozojmë se afërsisht **4,879** (25%) lëndë “më pak të rënda”, **11,124** (57%) lëndë ku mbrojtja “nuk është e detyruar” (mesatarisht të rënda), dhe **3,513** (18%) lëndë të mbrojtjes “së detyruar” (më të rënda) kanë hyrë në sistem. Këto të dhëna në përgjithësi (ndonëse jo saktësisht) përputhen me të dhënat nga KPK lidhur me numrin e aktakuzave në vitin 2022 (**5,585 persona** të akuzuar për krime të dënueshme me më pak se 10 vjet dënim maksimal, **2,407 persona** të akuzuar për krime me dënim maksimal mbi 10 vjet dhe **144 persona** të akuzuar nga Zyra e Prokurorisë Speciale).

**Aplikimi i standardit sipas KPP:** Tani, shtrohet pyetja se si mund të përcaktohet përqindja e këtyre lëndëve në të cilat i pandehuri do të ishte i pranueshëm për ndihmë juridike të financuar nga shteti sipas standardit të KPP në fazën gjyqësore (d.m.th., për të mbuluar nevojat në gjykata)? Para së gjithash, për qëllime të këtij Koncept Dokumenti dhe duke përdorur standardin e pranueshmërisë sipas KPP, teknikisht çdo i pandehur në kategorinë e lëndëve me “mbrojtje të detyruar” do të ishte i pranueshëm për ndihmë juridike në gjykatë, pasi nuk ka asnjë test të mundësive financiare për këto çështje (d.m.th., të gjitha **3,513** lëndët e vlerësuara teknikisht do të ishin të pranueshme për ndihmë juridike, gjë që, natyrisht, nuk do të thotë se të gjithë të pandehurit e pranueshëm në realitet do të kërkonin ndihmë juridike). Në mënyrë të ngjashme, mund të supozohet se sipas standardeve të KPP, asnjë nga të pandehurit në 4,879 lëndët “më pak të rënda” nuk do të ishin të pranueshëm për ndihmë juridike në gjykata.

Kategoria më e ndërlikuar është ajo me lëndët kur “mbrojtja nuk është e detyruar”, pasi KPP përmend vetëm të pandehurin që “sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet” për të angazhuar avokat mbrojtës si standard për pranueshmërinë dhe nuk përcakton saktësisht se çfarë do të thotë kjo. Nëse përdoret vlerësimi i Bankës Botërore që 23% e popullsisë ishte në ose nën “nivelin e varfërisë” në vitin 2022, kjo do të thotë përafërsisht **2,559** nga të pandehurit kur mbrojtja nuk është e detyruar do të ishin të pranueshëm për ndihmë juridike sipas standardit të KPP-së, krahas 3,513 për veprat penale e mbrojtjes së detyruar, duke arritur në total prej **6,072**.

Së këndejmi, numri i përgjithshëm i personave që janë të pranueshëm për ndihmë juridike në çështje penale sipas standardit të KPP në fazën gjyqësore do të ishte 6,072. Vetëm 1,933 avokatë u caktuan në fazën gjyqësore, që do të thotë se ka mangësi të konsiderueshme prej **4,139** lëndësh (ose **68%**). Me fjalë të tjera, vetëm **32%** e të pandehurve të pranueshëm marrin ndihmë juridike. Kjo krijon supozimin se asnjë avokat që caktohet (dhe llogaritet në statistikat zyrtare) në fazën e policisë ose prokurorisë nuk vazhdon angazhimin deri në fazën gjyqësore (dhe zyrtarisht numërohen kështu).

Meqë nuk ka qenë e mundur të gjenerohen statistika për numrin e të pandehurve ndaj të cilëve janë bërë kallëzime penale dhe të cilët japin deklaratat në stacion të policisë apo për

numrin e të pandehurve të tillë që shkojnë në prokurori për të dhënë deklaratë, nuk ka qenë e mundur të përcaktohet “mangësia” në ofrimin e ndihmës juridike në këto faza.

**Aplikimi i standardit sipas Ligjit për Ndhimë Juridike ose të së drejtës ndërkombëtare:** Nga ana tjetër, sikur të aplikoheshin standardet e pranueshmërisë sipas ANJF ose standardeve ndërkombëtare (thjesht kushdo që ballafaqohet me dënim me burgim dhe kalon testin e mundësive financiare), atëherë edhe **1,122 të pandehur** ( $4,879 \times 23\%$ ) shtesë do të ishin të pranueshëm për ndihmë juridike për veprat penale më pak të rënda dhe më pak persona do të ishin të pranueshëm për çështjet e mbrojtjes së detyruar në fazën gjyqësore. Kjo do të çonte në vlerësim total të ‘gjithësisë’ së nevojës për rastet penale.

**Kontradiktat brenda legjislacionit të Kosovës lidhur me të drejtën për ndihmë juridike penale:** Vlen të theksohet se ka kontradiktë ndërmjet dispozitës së LNJJF dhe KPP lidhur me të drejtën e ndihmës juridike penale falas. Neni 4, paragrafi 2 i Konventës së Lanzarotes thotë: “Ndhimja juridike falas ofrohet në procedura civile, penale, administrative dhe të kundërvajtjes” duke iu nënshtruar kriterëve të përcaktuara më sipër (domethënë që kërkuesi të plotësojë kriteret financiare dhe kriteret e tjera të pranueshmërisë”, të cilat nuk kufizojnë aspak disponueshmërinë e ndihmës juridike falas në çështjet penale në varësi nga dënimi maksimal i mundshëm me burgim, siç parashikon neni 56 (mbi pesë vjet, pa test të mundësisë financiare) dhe neni 57 (mbi tre vjet, me test të mundësisë financiare) i KPP-së. Së këndejmi, lihet mundësia e ofrimit të ndihmës juridike dhe përfaqësimit falas në të gjitha fazat e procedurës penale, pa marrë parasysh dispozitat ligjore të KPP lidhur me mbrojtjen e detyruar, të cilat në mënyrë specifike përcaktojnë se për cilat vepra penale duhet të ofrohet, madje sipas LNJJF ofrohet më shumë ndihmë juridike falas edhe për kundërvajtje.

Nga analiza e bërë, vërehet se çështjet e mbrojtjes së detyruar që i nënshtrohen testit të mundësive financiare janë  $3,513 \times 23\%$  ose 808 persona. Pastaj çështjet kur mbrojtja nuk është e detyrueshme që i nënshtrohen testit të mundësive financiare:  $11,124 \times 23\% = 2,559$  persona. Çështjet më pak të rënda:  $4,879 \times 23\% = 1,122$  persona. Kjo na sjell numrin në total = 4,489 persona të pranueshëm për ndihmë juridike penale sipas kriterëve të ANJF ose kriterëve të së drejtës ndërkombëtare të pranueshmërisë në fazën gjyqësore

Ky numër është në mënyrë thelbësore më i ulët sesa sipas standardit të KPP, duke qenë se këtu aplikohet testi i mundësive financiare në një numër të madh të lëndëve me mbrojtje të detyruar.

Duhet theksuar se përqindja e nivelit të varfërisë prej 23% sipas Bankës Botërore është mbase më e ulët sesa standardi sipas ANJF për ndihmën juridike primare, konkretisht “të gjithë personave të cilët përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale, ose janë në situatë të ngjashme me personat që përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale”, ose me fjalë të tjera thjesht askush në familje nuk është i punësuar në mënyrë domethënëse, por nuk ka të dhëna se çfarë është ajo përqindje e popullsisë në të vërtetë. Duhet të theksohet gjithashtu se do të kishte ulje të ndjeshme të kërkesës nëse përdoret standardi i pranueshmërisë për ndihmë juridike sipas ANJF/standardit ndërkombëtar, pasi sipas këtij standardi rastet e

“mbrojtjes së detyruar” në fakt do t’i nënshtroheshin testit të mundësive financiare. Kjo do të diskutohet më tej në seksionin për koston e ndihmës juridike.

Në bazë të këtyre llogaritjeve, vlerësohet se ka “mangësi” prej përafërsisht 2,556 lëndë (1,933 lëndë në të cilat është ofruar ndihmë juridike dhe 4,489 lëndë të pranueshme) ose 57% e totalit të lëndëve në të cilat i pandehuri është i pranueshëm për ndihmë juridike sipas standardit të ANJF ose standardit ndërkombëtar, por ku në realitet nuk ofrohet ndihmë juridike. Me fjalë të tjera, vetëm 43% nga të pandehurit e pranueshëm për ndihmë juridike sipas standardit të ANJF ose standardit ndërkombëtar, në realitet marrin ndihmë juridike. Ky është një vlerësim tejet konservator, megjithatë, (duke pasur parasysh se po përdoret 23% në bazë të nivelit të varfërisë sipas Bankës Botërore) dhe ka të ngjarë që ka shumë më tepër lëndë të pranueshme (kërkesa) që aktualisht nuk mbulojnë.

Për plotësimin e këtyre mangësive (hendekut) në mbulimin e ndihmës juridike do të paraqitet më në detaje në seksionin e analizës kosto/përfitim.

Përmbledhja e analizës së “mangësisë” është dhënë në formë të përmbledhur më poshtë:

| <u>Lloji i ndihmës juridike</u>           | <u>Gjithësia e nevojës</u> | <u>Mangësia e vlerësuar (nr. dhe %)</u> |
|---|----------------------------|---|
| Penale (përfaqësim sipas detyrës zyrtare) |                            |   |
| • Standardi sipas KPP                     | 6,072 lëndë                | 4,139 (68%) lëndë                       |
| • Std. sipas ANJF ose ndërkombëtar        | 4,489 lëndë                | 2,556 (47%) lëndë                       |
| Civile (primare <u>përmes</u> ANJF/OAK)   | 9,453 lëndë                | 8,948 (95%) lëndë                       |
| Admin. ( <u>përmes</u> ANJF)              | 1,458 lëndë                | 1,439 (98.7%) lëndë                     |
| Admin.(përmes ANJF/OAK)                   |                            | Minimale                                |

### 1.3.3. Cilësia e ndihmës juridike që ofrohet në Kosovë

#### **Cilësia e ndihmës juridike që ofrohet aktualisht në Kosovë (sfidat dhe mangësitë);**

Përveç si më sipër, ka mangësi serioze edhe në cilësinë e ndihmës juridike veçanërisht të ndihmës juridike primare në formën e përfaqësimit në procedurat gjyqësore. përfshirë por pa u kufizuar në programin e ofrimit të ndihmës juridike sipas detyrës zyrtare në çështjet penale në gjykatat themelore. Me përjashtim të zyrtarëve ligjorë të ANJF, si ofruet të ndihmës juridike në mënyrë ekskluzive me orar të plotë, të cilët i nënshtrohen sistemit disiplinor pranë ANJF, nuk ekziston asnjë sistem i mirëfilltë i “kontrollit të cilësisë” mbi avokatët që ofrojnë ndihmë juridike sipas detyrës zyrtare, veçanërisht në lidhje me përfaqësimin ligjor në çështjet para gjykatave. OAK ka funksion disiplinor, por sipas vetë

OAK si dhe akterëve të tjerë të sistemit, Oda rrallë ndërmerr veprim ndaj avokatëve për shkelje të detyrës ose përfaqësim jo-efektiv të klientëve.

Diskutimi në fokusgrup me datën 25 tetor 2023, me shtatë (7) klientë të ANJF, ku katër (4) kishin marrë ndihmë juridike primare nga një avokat i caktuar nga OAK, dhe tre (3) kishin marrë ndihmë juridike sekondare nga zyrtarët ligjorë të ANJF, ka gjeneruar rezultatet si në vijim. Tre nga shtatë (7) klientët e anketuar ishin vetëm klientë të ndihmës juridike të ofruar nga zyrtarët e ndihmës juridike të ANJF. Ata që të gjithë i dhanë zyrtarit të tyre ligjor nga ANJF 75/75 pikë ose 100% në pyetësorin për matjen e kënaqshmërisë. Në anën tjetër, katër (4) klientët e tjerë kishin marrë gjithashtu ndihmë juridike nga ANJF përmes mbrojtësit të caktuar nga lista e avokatëve të OAK dhe atyre iu kërkua vetëm të kualifikojnë ndihmën juridike që kanë marrë. Rezultatet e tyre ishin dukshëm më të ulëta, duke u renditur nga 60 (për raste të ndërlikuara të trafikimit/dhunës në familje) ose 80%, në 58 (77%), në 45 (60%), dhe deri në 35 (47%).

#### 1.3.3.1 Sfidat dhe mangësitë në cilësinë e ofrimit të ndihmës juridike

##### **Ndihma juridike në çështje penale përmes sistemit sipas detyrës zyrtare:**

Në Raportin e OSBE-së për Ndihmën Juridike të vitit 2022, vërehet një vlerësim i bazuar mirë dhe kryer profesionalisht i sistemit të ndihmës juridike në çështje penale sipas detyrës zyrtare dhe do të përdoret si burimi kryesor i informacionit cilësor dhe sasior në lidhje me cilësinë e ndihmës juridike penale që ofrohet.

Ky raport konstaton si në vijim::

- Nuk kishte dallim të madh në cilësi ndërmjet avokatëve mbrojtës sipas detyrës zyrtare dhe avokatëve mbrojtës privatë me pagesë (por nuk përfshihet asnjë lloj anketimi i klientëve, i cili do të ishte i dobishëm);
- Te sistemi sipas detyrës zyrtare “përgjithësisht duket se funksionon” por me disa vërejtje të rëndësishme; dhe
- Rregulloret (caktimi nga listat e OAK dhe jo drejtpërdrejt) aplikohen në përgjithësi, por jo gjithmonë, nga gjyqtarët dhe prokurorët në lidhje me caktimin nga listat sipas detyrës zyrtare.

Grafiku i mëposhtëm tregon përgjigjet e 212 gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve të anketuar kur u pyetën në lidhje me “funksionimin” e shërbimeve të ndihmës juridike penale sipas detyrës zyrtare (në vitin 2020):




Figura 2. Përgjigja ndaj deklaratës “funktionon mirë sistemi i emërimit të avokatëve sipas detyrës zyrtare nga Oda e Avokatëve të Kosovës në procedurat gjyqësore”

Grafiku i mëposhtëm nga Raporti tregon përgjigjet e pyetjes së ngjashme në lidhje me “shqetësimet” e 56 prokurorëve dhe avokatëve të anketuar për cilësinë e ndihmës juridike të ofruar nga avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare në çështjet penale në fazën e hetimit:




Figura 3. Shpeshtësia e shqetësimeve në lidhje me standardin e këshillimit ligjor gjatë fazës së hetimit



Dhe grafiku i mëposhtëm nga Raporti tregon përgjigjet e pyetjes së ngjashme në lidhje me “shqetësimet” e 56 prokurorëve dhe avokatëve të anketuar rreth “standardeve” të ndihmës juridike të ofruar nga avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare në çështjet penale në përgjithësi:




Figura 4. Shpeshtësia e shqetësimeve në lidhje me standardet e avokatit ex officio të raportuara nga gjyqtarët dhe prokurorët

Në një shënim përfundimtar, vërehet shkallë relativisht e lartë e dënimeve në Kosovë (e cila është 81% e të gjitha rasteve penale) që mund të jetë tregues i një cilësie të ulët të ndihmës juridike penale që po ofrohet, përveç faktit se kaq shumë të pandehur të kualifikuar për ndihmë juridike (përafërsisht 68% sipas standardit CPC ose 47% sipas standardit Ligjit Ndihmës Juridike/të drejtës ndërkombëtare) nuk po e marrin atë (shih më lartë).

#### **Sfidat/Mangësitë lidhur me cilësinë e ndihmës juridike në çështjet penale sipas detyrës zyrtare:**

Disa nga gjetjet kryesore nga Raporti i OSBE-së për Ndihmën Juridike lidhur me sfidat ose kufizimet (mangësitë) në sistemin aktual të caktimit sipas detyrës zyrtare në lidhje me cilësinë e ndihmës juridike të ofruar përfshijnë:

- Ka pasur shqetësime “shpesh” ose “shumë shpesh” të shprehura nga gjyqtarët dhe prokurorët për cilësinë e përfaqësimit në 30% të lëndëve të caktuara sipas detyrës zyrtare (kundrejt 23% të personave që kanë shqetësime të tilla për cilësinë e përfaqësimit nga avokati privat);
- Pagesat e ulëta (me vetëm 40% të nivelit të tarifës që paguhet nga klientët privatë) për avokatët nuk i stimulojnë avokatët për të ofruar ndihmë juridike me cilësi të lartë – deri më sot, nuk ka pasur fare rritje në shumat e pagesave për avokatët sipas detyrës zyrtare që nga viti 2014, gjë që avokatët e konsiderojnë përbuzje të madhe;
- Kufiri i mëparshëm prej 500 € për lëndë në muaj për ndihmën juridike në çështjet penale mund të krijojë shtysë për zvarritjen e lëndëve dhe moszgjdhjen e tyre,

duke ndikuar në të gjithë sistemin e drejtësisë penale. Aktualisht, vetëm 2% e lëndëve zgjidhen me marrëveshje të pranimit të fajësisë (krahasuar, për shembull, me Shtetet e Bashkuara ku mbi 95% të lëndëve zgjidhen me marrëveshje të pranimit të fajësisë), sipas statistikave nga KPK. Mekanizmi i “pagesës për secilin veprim” (sipas të cilit avokatët paguhet për t’u paraqitur në gjykatë dhe për të shtyrë procedimin e lëndës) mund të nxisë ngurrimin për të hyrë në marrëveshje për pranimin e fajësisë;

- Sipas sistemit aktual nuk paguhet asnjë kompensim për konsultimet me klientët, shpenzimet e udhëtimit ose hetimit. Kjo dekurajon kryerjen e këtyre veprimeve të rëndësishme dhe të nevojshme, të cilat janë kyç për drejtësinë që përqendrohet te qytetari dhe qartësisht janë pjesë e ofrimit të ndihmës juridike me cilësi të lartë;
- Sistemi i pagesave është tepër burokratik, duke rezultuar në humbje të madhe të burimeve të kufizuara;
- Nuk ruhet gjithmonë vazhdimësia ose vertikalteteti i përfaqësimit ku klientët marrin avokatë të ndryshëm në faza të ndryshme të procesit, që bie ndesh me standardet e cilësisë së ndihmës juridike;
- Fare pak të dyshuar marrin ndihmë juridike përpara marrjes në pyetje në polici (që shkel standardin e cilësisë së ndihmës juridike të përfaqësimit sa më të hershëm). Kjo me sa duket është përmirësuar që nga viti 2020 kur u zhvilluan anketat e OSBE-së, siç tregohet nga numri i lartë i caktimeve *sipas detyrës zyrtare* në stacion të policisë;
- Caktimet nuk bëhen fare sipas nivelit të përvojës apo specializimit, kështu që avokatët e papërvojë mund të marrin çështje tepër komplekse, duke rezultuar në cilësi të dobët të ndihmës juridike;
- Shqetësime të shprehura nga shumë respondentë që thonë se shumica e avokatëve të caktuar *sipas detyrës zyrtare* kanë nevojë për më shumë trajnime të specializuara, të cilat aktualisht u ofrohen shumë pak;
- Edhe në rastet kur avokati mbrojtës *sipas detyrës zyrtare* është i pranishëm, mbrojtja shpesh nuk angazhohet në procedura në mënyrë aq aktive sa duhet (d.m.th., ofron mbrojtje thjesht formale) duke ndikuar në cilësinë e ndihmës juridike që ofrohet;
- Avokatët e caktuar *sipas detyrës zyrtare* shpesh kanë vështirësi në realizimin e qasjes në shkresat e lëndës dhe provat fajësuese/shfajësuese ose fare nuk i kërkojnë ato (44% e prokurorëve thonë se mbrojtja madje as nuk i kërkon provat fajësuese);
- Vonesat në caktime rezultojnë në kohë të papërshtatshme të përgatitjes, gjë që nga ana tjetër rezulton në më shumë shtyrje ose ndryshim në caktimin e avokatit që ndikon në vazhdimësinë e përfaqësimit;
- Nuk ka “sistem të sigurimit të cilësisë së ndihmës juridike”, gjë që ndikon ndjeshëm në cilësinë e ndihmës juridike që ofrohet.

### 1.3.3.2.Kostoja e ndihmës juridike që ofrohet aktualisht në Kosovë

Kostoja e sistemit të ndihmës juridike që përdoret aktualisht në Kosovë është elementi i tretë kyç i këtij Koncept Dokumenti. Kjo i përgjigjet shqetësimeve në lidhje me financimin dhe burimet e financimit të ndihmës juridike në Kosovë.

#### **Të dhënat e mbledhura lidhur me kostot e ndihmës juridike të financuar nga shteti:**

Kostot e përgjithshme (për tarifën e avokatëve) që lidhen me sistemin e caktimit sipas detyrës zyrtare për ofrimin e ndihmës juridike në vitin 2022 ishin si më poshtë:

- Për avokatët nga OAK të caktuar sipas detyrës zyrtare të paguar përmes KGJK në çështje penale (të caktuar nga gjyqësori): **797,991€**
- Për avokatët nga OAK të caktuar sipas detyrës zyrtare të paguar përmes KPK në çështje penale (të caktuar nga policia dhe prokuroria): **443,407€**
- Për avokatët e OAK të paguar përmes ANJF në çështje civile, administrative dhe penale: **106,733€**

Për sa i përket kostove totale për ndihmën juridike të financuar nga shteti në Kosovë, sipas një raporti të kohëve të fundit nga Komisioni Evropian në vitin 2022:

*“Niveli i ndihmës juridike (si për viktimat ashtu edhe për të dyshuarit/të akuzuarit), ndonëse i përmirësuar, mbetet i pamjaftueshëm për shkak të legjislacionit kundërthënës, mungesës së ndërgjegjesimit publik dhe sistemeve të ndryshme për ofrimin e ndihmës juridike falas. Buxheti i ndarë për ndihmë juridike në vitin 2022 ishte 1,877,134 euro, me rritje 9.4% krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, buxheti i implementuar në vitin 2022 ishte 1,692,393 euro, ngjashëm me vitin 2021 (1,686,056 euro). Problem mbetet mungesa e sistemit të sigurimit të cilësisë së ndihmës juridike falas.”*

Shuma totale e buxhetit të ekzekutuar nga Qeveria e Kosovës për ndihmë juridike ishte **1,692,393 €** (në krahasim me buxhetin e ndarë, që ishte **1,877,134 €**) për vitin 2022. Kjo u kanalizua nëpërmjet tre institucioneve të ndryshme: KPK - kryesisht ndihmë juridike sipas detyrës zyrtare në çështje penale që caktohet në fazën hetimore ose paraprake (me **443,407 €** tarifa avokati për avokatët e caktuar nga OAK); KGJK - kryesisht ndihmë juridike sipas detyrës zyrtare në çështje penale që caktohet në fazën gjyqësore (me **797,991€** tarifa avokati për avokatët e caktuar nga OAK); dhe ANJF - me të gjithë buxhetin e saj prej **450,995 €**. Në ANJF, kostoja totale për tarifën e avokatëve të caktuar nga OAK në çështje kryesisht civile dhe administrative me ofrim të ndihmës juridike primare dhe sekondare (gjithsej 555 lëndë, që përbëhen nga 505 çështje civile, 19 çështje administrative dhe 31 çështje penale më pak të rënda) në vitin 2022 ishte **106,733 €**. Për qëllime krahasimi, grafiku i mëposhtëm tregon se shifrat lidhur me modelin e ofrimit të ndihmës juridike me caktim sipas detyrës zyrtare të paguar nga KPK dhe KGJK janë pak a shumë në harmoni me tre vitet e mëparshme 2019-2021 (me rënie të dukshme për vitin 2020, viti më i keq i pandemisë):




Figura 5. Shpenzimet për emërimet sipas detyrës zyrtare sipas institucionit

Të dhënat e mëposhtme tregojnë koston e paguar ndër vite nga ANJF për caktimin e avokatëve mbrojtës nga OAK,

| Viti | Shuma totale e mjeteve financiare të shpenzuara nga ANJF për angazhimin e avokatëve të OAK-së ndër vite (euro) |
|------|--|
| 2017 | 72,884.00€   |
| 2018 | 77,783.00€   |
| 2019 | 83,788.50€   |
| 2020 | 54,527.50€   |
| 2021 | 91,009.55€   |
| 2022 | 106,733.00€  |

| TARIFAT E AVOKATËVE SIPAS ZYRËS RAJONALE TË ANJF 2017-2022 |           |           |           |           |           |            |               |
|--|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|---------------|
| RAJONI/VITI  | 2017      | 2018      | 2019      | 2020      | 2021      | 2022       | Totali (euro) |
| PRISHTINË  | 15,421.50 | 17,130.00 | 21,285.00 | 8,822.50  | 17,852.50 | 25,375.50  | 105,887.00    |
| PEJË   | 17,720.00 | 22,200.00 | 23,380.00 | 16,545.00 | 17,745.00 | 17,115.00  | 114,705.00    |
| PRIZREN  | 11,610.00 | 8,130.00  | 6,145.00  | 5,652.50  | 11,067.50 | 15,585.00  | 58,190.00     |
| GJILAN   | 18,787.50 | 21,543.00 | 24,173.50 | 14,480.00 | 22,944.50 | 19,602.50  | 121,531.00    |
| MITROVICË  | 6,485.00  | 6,140.00  | 5,080.00  | 5,180.00  | 11,620.00 | 12,270.00  | 46,775.00     |
| GJAKOVË  | 2,015.00  | 925.00    | 2,175.00  | 1,945.00  | 5,885.00  | 7,375.00   | 20,320.00     |
| FERIZAJ  | 845.00    | 1,715.00  | 1,550.00  | 1,902.50  | 3,895.00  | 9,410.00   | 19,317.50     |
| TOTAL  | 72,884.00 | 77,783.00 | 83,788.50 | 54,527.50 | 91,009.50 | 106,733.00 | 486,725.50    |

**Llogaritjet e “kostos për lëndë”:** Për modelet e ofrimit të ndihmës juridike që aktualisht implementohen në ANJF (kryesisht për çështje civile dhe administrative dhe fare pak çështje penale ose kundërvajtje) dhe modelit të ndihmës juridike me caktim sipas detyrës

zyrtare të financuar nga KPK dhe KGJK, llogaritjet për përcaktimin e “kostos për lëndë” janë mjaft të thjeshta siç tregohet në seksionet e mëposhtme:

### **Lëndë kryesisht civile dhe administrative nga ANJF**

- (1A) Numri i çështjeve (kryesisht) civile dhe administrative nga ANJF të caktuara avokatëve të OAK në vitin 2022: **555**
- (1B) Kostoja totale e tarifave të avokatëve e paguar për avokatët e OAK në vitin 2022: **106,733 €**
- (1C) Kostoja mesatare për lëndë në 2022 (1B / 1A): **192 € për lëndë**

### **Lëndë penale (d.m.th., caktime) para policisë dhe prokurorëve të paguara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)**

- (2A) Numri i lëndëve të paguara nga KPK të kryera nga avokatët e OAK në vitin 2022: 4,912 në stacion të policisë dhe 1,096 në prokurori për total prej **6,008**
- (2B) Kostoja totale e tarifave të avokatëve e paguar nga KPK për avokatët e OAK në vitin 2022: **443,407 €**
- (2C) Kostot totale të vlerësuara që lidhen me administrimin e programit të caktimit sipas detyrës zyrtare nga KPK në vitin 2022: **PTC**
- (2D) Kostoja mesatare për lëndë në 2022 (2B + 2C) / 2A: **73 €**

### **Lëndë penale (d.m.th., caktime) para gjyqtarëve të paguara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)**

- (3A) Numri i lëndëve të paguara nga KGJK të kryera nga avokatët e OAK në vitin 2022: **1,933**
- (3B) Kostoja totale e tarifave të avokatëve e paguar nga KGJK për avokatët e OAK në vitin 2022: **797,991 €**
- (2C) Kostot totale të vlerësuara që lidhen me administrimin e programit të caktimit sipas detyrës zyrtare nga KPK në vitin 2022: **PTC**
- (3D) Kostoja mesatare për lëndë në 2022 (3B + 3C) / 3A: **412 €**

**Kostoja mesatare totale për lëndë (caktim) për sistemin e ndihmës juridike në çështje penale me caktim sipas detyrës zyrtare**  $(2B + 3B) / (2C + 3C) = 1,241,398 / 7,941 = 156 €$

## **Analiza e Përdorimeve të Modeleve të ndryshme të ofrimit të ndihmës juridike falas në Kosovë**

**Modeli i Mbrojtësve Publik të ANJF-së për Ndihmën Juridike të ofruar nga zyrtarët e ANJF:**

Nga të gjitha modelet e ndihmës juridike që funksionojnë në Kosovë, ky është deri tani ai që është më kosto-efektiv dhe më efikas, sipas gjetjeve të realizuara në këtë Koncept

Dokument. ANJF ofron ndihmë në të gjitha rajonet e Kosovës në mbi 5300 raste në vit me një staf teknik prej vetëm 23 “zyrtarë ligjorë”. Institucioni duket se po plotëson kërkesën për ndihmë juridike dytësore, pasi deri më sot nuk i është dashur të refuzojë klientët e kualifikuar për shërbimet e tij, gjë që është mjaft mbresëlënëse, duke pasur parasysh boshllëqet e mëdha në asistencë në elementet e tjera të ndihmës juridike në Kosovë. Nivelet e kënaqësisë së klientëve duket të jenë shumë të larta, sipas vizitave në terren gjatë hulumtimit për këtë Koncept Dokument si dhe një fokus grupi me shtatë (7) klientë të ANJF-së më 25 tetor 2023 (për të cilin shërbimet e ofruara nga institucioni përmes zyrtarëve të tij ligjorë ka marrë një rezultat perfekt 75/75 në aplikimin e instrumentit të anketimit të kënaqësisë). Ndryshe nga shumica e mekanizmave të tjerë që veprojnë për të ofruar ndihmë juridike të financuar nga shteti në Kosovë (dhe veçanërisht ndryshe nga sistemi *ex officio* për ofrimin e ndihmë juridike penale), ANJF ka ofruar ose ka siguruar ofrimin e një trajnimi thelbësor dhe të vazhdueshëm për të gjithë stafin e saj në shumicën, nëse jo të gjitha, aspektet përkatëse, si funksionimin e tij teknik dhe ka disa manuale praktike që i ka përcaktuar dhe zbatuar dhe që po përdoren nga stafi për të përmirësuar cilësinë. ANJF ka përcaktuar dhe miratuar standardet e kontrollit të cilësisë (shih më lartë) në fushën e së drejtës civile dhe administrative dhe këto janë duke u zbatuar nëpërmjet rishikimeve periodike të performancës së stafit të agjencisë. ANJF është i vetmi institucion që prodhon çdo statistikë kuptimplotë dhe të zbërthyer për ofrimin e ndihmës juridike, e cila është kritike për përcaktimin e planeve strategjike dhe të punës institucionale, si dhe për marrjen e vendimeve të bazuara në prova.

**Modeli i Mbrojtësit të Caktuar i ANJF-së** do të ofrojë ndihmë juridike nga grupi i parë (përfaqësimi) në rastet kryesisht të së drejtës civile dhe administrative sipas përcaktimeve në nenin 85, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/1-006 për Procedurën Kontestimore: Ndërsa mekanizmi për të ofruar ndihmë juridike përmes zyrtarëve ligjorë ekskluzivë me kohë të plotë të ANJF-së duket se funksionon në një nivel shumë të lartë, ACM për ofrimin e ndihmës juridike parësore (përfaqësimi i rastit) nuk funksionon aspak mirë dhe tregon shumë nga disavantazhet e një mekanizmi të bazuar në këshillat e caktuara. Vlerësohet se është shumë e vështirë të gjenden avokatë të kualifikuar që janë të gatshëm të pranojnë shkallën e ulët të shpërblimit ka qenë "kufi" në 500 euro për rast. Përderisa ANJF ka një marrëveshje me OAK për për zgjedhjen dhe caktimin (nga OAK) të avokatëve, OAK shpesh nuk mund t'i gjejë ata. Për këtë arsye, ANJF shpesh duhet të thërrasë nga 8 deri 10 avokatë përpara se të jetë në gjendje të gjejë një të gatshëm për të pranuar rastin. Edhe pse avokati i interesuar gjendet, sipas të dhënave të ofruara nga OAK, disa prej avokatëve i braktisin lëndët. Një mekanizëm kompensimi i “kufizuar” për rast, është ndoshta mekanizmi që krijon sasinë më të vogël të nxitjes (krahasuar me modelet e tjera) për avokatët për të ofruar kujdes të cilësisë së lartë. Sipas zyrtarëve ligjorë në zyrat në terren të ANJF-së, klientët ankohen herë pas here për avokatin e caktuar në rastet e tyre pasi ato raste janë të vështira për t'u arritur dhe nuk shpenzojnë kohën e duhur për t'i informuar përfituesit e ndihmës juridike falas se çfarë po ndodh dhe cilat janë hapat e ardhshëm. Megjithatë, pavarësisht këtyre problemeve, mekanizmi duket se po jep rezultate pozitive, pasi klientët fitojnë në 94% të rasteve të tyre. Për sa i përket sasisë, ky model ACM dha

rezultatet më të këqija në krahasim me modelet e tjera të studiuara (d.m.th., mekanizmi i ndihmës juridike penale *ex officio*) dhe po ofron ndihmë juridike vetëm për 5% të atyre klientëve që ndoshta do të kualifikoheshin për të njëjtën gjë në raste civile dhe për 1.3% të klientëve që ndoshta do të kishin të drejtë për shërbime të ndihmës juridike në lëminë administrative për ndihmë juridike parësore. ANJF ACM nuk është me kosto efektive me një kosto prej **192 euro** për rast (shih më lartë). Siç u parashtrua më lart, nëse ANJF do të zbatonte një model të mbrojtësit publik/ndihmës juridike institucionale për të trajtuar ndihmën juridike të ofruar nga avokatët e angazhuar në çështjet e së drejtës civile dhe administrative, atëherë kostoja për rast do të binte në 60% të kostos për rast nga modeli aktual MMC.

#### 1.4. Lista e dokumenteve të politikave dhe ligjeve në fuqi

Korniza për ofrimin e ndihmës juridike në Kosovë sipas të drejtës vendore dhe ndërkombëtare është shumëdimensionale por ka ca mospërputhje lidhur me atë se çfarë është ndihma juridike në të vërtetë, kush e gëzon këtë të drejtë, si realizohet qasja në të dhe kush në të vërtetë paguan dhe monitoron cilësinë dhe si bëhet kjo.

Për funksionimin adekuat të sistemit të ndihmës juridike në Kosovë, është krijuar një kornizë ligjore, që përfshinë legjislacionin primar dhe sekondar, si dhe ligjet 'e buta', siç janë, politikat strategjike ose udhëzuesit, që përshkruajnë dhe promovojnë praktikën më të mira në zbatimin e legjislacionit.

Në këtë drejtim, në figurën e mëposhtme renditen dokumentet e politikave, ligjet, aktet nënligjore dhe dokumente të tjera që ndërlidhen me funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas në Kosovë.

Figura 7 - Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

| Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor | Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare | Institucioni (et) shtetëror (e) përgjegjës (e) për zbatim  | Roli dhe detyrat e Institucionit(eve)   |
|---|--|--|---|
| Kushtetuta e Republikës së Kosovës              | <u>Gazeta Zyrtare</u>  | Ministria e Drejtësisë<br><br>Agjencia për Ndhimë Juridike Falas<br><br>Gjykatat e Republikës së Kosovës | <p><u>Kushtetuta e Republikës së Kosovës</u> e vitit 2008. Sipas shembujve të rregullimeve në të drejtën krahasuese bashkëkohore, Kushtetuta e Kosovës garanton të drejtën për ndihmë juridike për çdo individ (neni 30), ku kjo e drejtë në sistemin tonë juridik për herë të parë ka fituar statusin e të drejtës së garantuar me kushtetutë. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 31, paragrafi 6), e drejta për ndihmë juridike, duke përfshirë ndihmën juridike falas, përkufizohet si vijon: <b><u>“Ndhimja juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.”</u></b></p> <p>Ndhimja juridike falas në Republikën e Kosovës është e rregulluar më hollësisht dhe mund të ushtrohet sipas kushteve të përkufizuara me Ligjin për Ndhimën Juridike Falas (në çështje civile, administrative, penale dhe kundërvajtje) dhe me Kodin e Procedurës Penale, të ndryshuar në vitin 2022, në çështje penale (dhe do të diskutohet në detaje më poshtë).</p> |



|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
|  |  |  | <p>Garantimi kushtetues i së drejtës për ndihmë juridike e detyron shtetin të sigurojë kushtet për gëzimin dhe mbrojtjen e kësaj të drejte. Rrjedhimisht, shteti ka për detyrë të rregullojë ligjërisht ofrimin e ndihmës juridike, gjë që nënkupton edhe detyrimin e shtetit për të siguruar ofrimin e ndihmës juridike falas.</p> <p>Detyrimet e Republikës së Kosovës për të rregulluar ofrimin e ndihmës juridike burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila garanton të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 paragrafi 2), si dhe të drejtën për ndihmë juridike, si e drejtë e posaçme e njeriut (neni 30, paragrafi 1, nën paragrafi (5) i Kushtetutës), gëzimin dhe mbrojtjen e së cilës shteti duhet ta sigurojë. Po ashtu, për të rregulluar me ligj dhe për të funksionalizuar ofrimin e ndihmës juridike, përfshirë ndihmën juridike falas, Republika e Kosovës është e detyruar edhe nga parakushtet e shumta në procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës, ku Republika e Kosovës ka bërë kërkesë dhe rekomandimet e të cilit është e detyruar t'i implementojë.</p> <p>E drejta për ndihmë juridike është një nga të drejtat kushtetuese që shteti garanton për krijimin e mundësive të barabarta për përdorimin efektiv të të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare (neni 19 i Kushtetutës).</p> <p>Detyrimi i përgjithshëm kushtetues lidhur me të drejtën për ndihmë juridike përfshin detyrën e shtetit për të krijuar kornizën e nevojshme normative të ndihmës juridike dhe për të siguruar kushtet për gëzimin dhe mbrojtjen e kësaj të drejte, në përputhje me nenin 1 të Kushtetutës, sipas të cilit Republika e Kosovës përkufizohet si shtet që respekton të drejtat dhe liritë e të gjithë</p> |
|--|--|--|--|

|                                 |                       |  |  |
|---------------------------------|-----------------------|--|--|
|                                 |                       |  | <p>qytetarëve dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj. Në këtë kuptim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton ndalimin e çdo forme të diskriminimit (neni 7 dhe neni 24 i Kushtetutës).</p> <p>Në Republikën e Kosovës ka sfida dhe kufizime serioze për sa i përket gëzimit të së drejtës për qasje në drejtësi, të cilat, ndër të tjera, janë pasojë e infrastrukturës joadekuate ligjore dhe burimeve të kufizuara financiare të ndara për ndërjegjësimin lidhur me këtë çështje dhe ofrimin e ndihmës juridike falas. Prandaj, është e nevojshme të kapërcehen këto sfida dhe të krijohet sistem gjithëpërfshirës, funksional dhe efikas i ndihmës juridike falas, i cili do të siguronte barazi në qasjen në drejtësi.</p> <p>Duke marrë parasysh drejtimit strategjike të zhvillimit të Republikës së Kosovës dhe përpjekjet e bëra nga shteti për vendosjen e plotë të sundimit të ligjit, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, që është parakusht për anëtarësim në Bashkimin Evropian, në sistemin e Ndihmës Juridike Falas deri më tani janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm por të pamjaftueshëm drejt krijimit të një sistemi të ndihmës juridike efektive, efikase dhe financiarisht të qëndrueshme, që plotëson nevojat e qytetarëve dhe kontribuon në vendosjen e shtetit ligjor dhe rendit juridik, si dhe rikthen besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe avancimin e mëtutjeshëm të shtetit në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.</p> |
| <b>Kodi i Procedurës Penale</b> | <u>Gazeta Zyrtare</u> | Ministria e Drejtësisë<br><br>Agjencia për Ndihmë Juridike Falas | <b>Kodi i Procedurës Penale i vitit 2022 (KPP):</b> KPP jep detaje shumë specifike në lidhje me dhënien e ndihmës juridike penale (përmes “avokatit të caktuar” ose përfaqësimit <i>sipas detyrës zyrtare</i> përmes OAK paguar nga KPK dhe KGJK) dhe në të cilat raste mbrojtja “e detyruar” (që do të thotë se lënda nuk mund të procedojë ligjërisht pa përfaqësim nga avokati mbrojtës) ose është  |

|  |  |   |  |
|--|--|---|--|
|  |  | <p>Gjykatat e Republikës së Kosovës</p> | <p>“jo e detyruar” (d.m.th., nga e drejta për avokat mbrojtës mund të hiqet dorë në lëndë të caktuara dhe lëndët e tilla mund të procedohen në gjykatë pa avokat mbrojtës). Sipas nenit 52 (e drejta e të pandehurit për të pasur mbrojtës), i dyshuari dhe i pandehuri kanë të drejtë të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale. Para çdo marrjeje në pyetje të të dyshuarit ose të pandehurit, policia ose organi tjetër kompetent, prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues udhëzon të dyshuarin ose të pandehurin për të drejtën e tij në angazhimin e mbrojtësit dhe që mbrojtësi mund të jetë prezent gjatë marrjes së tij në pyetje.</p> <p>Në rastet kur nuk parashihet mbrojtja e detyruar, nga e drejta për të pasur mbrojtës mund të hiqet dorë, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtën e tij në mbrojtje. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i dyshuari apo i pandehuri dhe nga organi kompetent që e zbaton procedurën, ose mund të bëhet gojarisht në audio apo videokasetë, autenticiteti i të cilës verifikohet nga gjykata. Personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet nuk mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës. Personat të cilët tregojnë shenja të çrregullimeve ose të paaftësisë mendore nuk mund të heqin dorë nga e drejta në angazhimin e mbrojtësit. Kur i dyshuari ose i pandehuri i cili ka hequr dorë nga e drejta në angazhimin e mbrojtësit më vonë e kërkon sërish këtë të drejtë, ai këtë mund ta ushtrojë menjëherë.</p> <p>Sipas nenit 53, për mbrojtës mund të angazhohet vetëm avokati i cili është anëtar i OAK.</p> |
|--|--|---|--|

|  |  |  |   |
|--|--|--|---|
|  |  |  | <p>Neni 54 parashikon se mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje, pavarësisht se a është bërë veçimi i procedurës apo fazës së procedurës.</p> <p>Sipas nenit 56 (Mbrojtja e detyruar), i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste të mbrojtjes së detyruar: (1) nga marrja në pyetje për herë të parë e deri në përfundim të procedurës penale me vendim të formës së prerë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses; (2) nga arrestimi, gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës <u>derisa ai gjendet në paraburgim</u>; (3) nga momenti i marrjes në pyetje për herën e parë për vepër penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim; (4) në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm; (5) në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë marrëveshje për pranimin e fajësisë; ose (6) në të gjitha rastet kur i akuzuari gjykohet në mungesë sipas nenit 303 të KPP. Në qoftë se i pandehuri në rastin e “mbrojtjes së detyruar” nuk angazhon mbrojtës, e angazhimin nuk e bën askush nga personat në nenin 52 paragrafi 7 të KPP-së, gjyqtari kompetent ose organi tjetër kompetent që e zbaton procedurën i cakton një mbrojtës <i>sipas detyrës zyrtare</i> me shpenzime publike. Nuk ka asnjë test të “mjeteve” për caktimin e avokatit mbrojtës në rastet e mbrojtjes së detyruar sipas nenit 52 të KPP-së, që do të thotë se edhe të pandehurit më të pasur mund të marrin avokat mbrojtës falas të paguar nga shteti në lëndët që bien në kuadër të nenit 52. Përfshirja e një testi të mundësive financiare në kuadër të nenit 52 (ose zbatimi i detyrimit për të rimbursuar shtetin për kostot e</p> |
|--|--|--|---|

|                                  |                       |   |  |
|----------------------------------|-----------------------|---|--|
|                                  |                       |   | <p>ndihmës juridike nëse ndihma juridike falas u ofrohet të pandehurve që qëndrojnë mirë financiarisht) nuk do të shkelte në asnjë mënyrë të drejtën ndërkombëtare dhe në fakt do të ishte në përputhje me praktikën e mira në shumicën e vendeve të tjera të rajonit dhe botës me sisteme funksionale të ndihmës juridike.</p> <p>Sipas nenit 57 të KPP-së (Mbrojtësi me shpenzime publike kur mbrojtja nuk është e detyruar), kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse: (1) sipas gjendjes pasurore të tij <u>nuk mund t'i përballojë</u> shpenzimet e mbrojtjes; <b>dhe</b> plotësohet një nga kushtet e mëposhtme: (1) procedura penale zhvillohet për veprë penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim prej <u>tre (3) apo më shumë vjet burgim</u>; ose këtë e kërkojnë <u>interesat e drejtësisë</u> pavarësisht nga dënimi i paraparë. Para caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike sipas nenit 57, i pandehuri duhet të dorëzojë një deklaratë duke cekur pasuritë e tij dhe të deklarojë se nuk mund të përballojë shpenzimet e mbrojtësit. Në përputhje me nenin 11 të KPP-së, të pandehurit i caktohet mbrojtës i pavarur, me përvojë dhe me kompetencë në përputhje me llojin e veprës penale dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod.</p> |
| <b>Ligji për Ndhmën Juridike</b> | <u>Gazeta Zyrtare</u> | Ministria e Drejtësisë<br><br>Agjencia për Ndihe Juridike Falas | <b>Ligji për Ndhmën Juridike i vitit 2012 (LNJFF):</b> Neni 4 i LNJF-së parashikon sa vijon: <ul style="list-style-type: none"> <li>● Ndhma juridike falas ofrohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.</li> <li>● Ndhma juridike falas ofrohet në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.</li> <li>● Ndhma juridike falas jepet për këto lloje:</li> </ul>  |

|  |  |   |  |
|--|--|---|--|
|  |  | <p>Gjykatat e Republikës së Kosovës</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>○ informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;</li> <li>○ përpilimin e shkresave dhe tërë asistencën tjetër teknike, që ka të bëjë me kompletimin e lëndës; dhe</li> <li>○ përfaqësimin në procedurë civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.</li> </ul> <p>Neni 5 parashikon që ndihma juridike mund të jetë primare (ose sekondare). Sipas nenit 5, ndihma juridike “primare” përfshin shërbimet vijuese:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>(1) informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;</li> <li>(2) përpilimin e shkresave dhe tërë ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës;</li> <li>(3) përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse;</li> <li>(4) mbrojtjen dhe përfaqësimin në të gjitha fazat e procedurës penale;</li> <li>(5) informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat kundërvajtëse; dhe</li> <li>(6) informatat, këshillat juridike dhe ndihma në procedurat e ndërmjetësimit, arbitrazhit ashtu siç është paraparë me ligjet në fuqi.</li> </ol> <p>Ndihma juridike “sekondare” mbulon vetëm shërbimet të cilat janë paraparë në pikat 2 dhe 3 më sipër.</p> <p>LNJF përcakton: (1) kriteri kualifikues (shtetasit e Kosovës me vendbanim në Kosovë, personat me qëndrim në Kosovë dhe personat e tjerë sipas të drejtës ndërkombëtare të bazë të</p> |
|--|--|---|--|

|                               |                          |                        |  |
|-------------------------------|--------------------------|------------------------|--|
|                               |                          |                        | <p>reciprocitetit (neni 7); (2) kriteri financiar (ku ndihma juridike primare u ofrohet “ të gjithë personave të cilët përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale, ose janë në situatë të ngjashme me personat që përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale” dhe ndihma juridike sekondare u ofrohet të gjithë personave, të ardhurat e përgjithshme familjare të të cilëve janë më të vogla sesa të ardhurat mesatare familjare (neni 8); dhe (3) kriteri juridik, ku ndihma ofrohet duke vlerësuar bazueshmërinë e rastit sipas vlerës reale të kërkesës, fuqinë argumentuese të provave të paraqitura nga kërkuesi dhe mundësinë e suksesit të kërkesës (neni 9). Së këndejmi, e gjithë ndihma juridike falas sipas LNJF, përfshirë ndihmën juridike në çështjet penale (ndryshe nga ndihma juridike që ofrohet sipas KPP), ajo e ofruar nga ANJF, i nënshtrohet vlerësimit të kriterëve, ndryshe nga ndihma juridike penale falas në rastet e mbrojtjes së detyruar ose rasteve ku interesat e drejtësisë diktojnë ofrimin e ndihmës juridike falas nga shteti. Si çështje praktike, sipas intervistave me drejtuesit dhe stafin e ANJF-së, për shkak të burimeve të kufizuara, jo të gjithë personat që do të kualifikoheshin për ndihmë juridike primare sipas pikës 3 më sipër (që është përfaqësimi në gjykatë) në fakt i marrin këto shërbime dhe duhet të bëhet caktimi selektiv i prioriteteve, kryesisht bazuar në seriozitetin dhe kompleksitetin e lëndës. Kjo është konfirmuar nga Raporti i GIZ për Ndhmën Juridike i vitit 2023.</p> <p>Neni 10 i LNJF parashikon që “ndihma juridike falas e menjëhershme” ofrohet “përgjithësisht” në raste urgjente për të gjithë personat e ndaluar nga policia, pavarësisht përmbushjes së kriterëve të cilat kërkohen me LNJF.</p> |
| <b>E drejta ndërkombëtare</b> | <u>Kuvendi i Kosovës</u> | Ministria e Drejtësisë | <b>E drejta ndërkombëtare:</b> Sipas të drejtës ndërkombëtare, dispozitat për ofrimin e ndihmës juridike parashikojnë të drejtë  |

|  |                              |   |   |
|--|------------------------------|---|---|
|  |                              | <p>Agjencia për Ndhimë Juridike Falas</p> <p>Gjykatat e Republikës së Kosovës</p>                               | <p>shumë më të gjerë për ndihmë juridike sesa LNJF ose KPP. Për shembull, në çështjet penale, ndihma juridike thjesht do të duhej të vihet në dispozicion për çdo të pandehur që i nënshtrohet burgimit të mundshëm që nuk ka mundësi financiare për të paguar avokatin dhe do të duhej t'i ofrohet ndihmë juridike. Në çështjet civile, ndihma juridike do të duhej të ofrohet nëse këtë e diktojnë "interesat e drejtësisë".</p>  |
| <p><b>Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut</b></p> | <p><u>Gazeta Zyrtare</u></p> | <p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Agjencia për Ndhimë Juridike Falas</p> <p>Gjykatat e Republikës së Kosovës</p> | <p><b><u>Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut</u></b>, garanton të drejtën për proces të rregullt (neni 6, paragrafi 1), si e drejtë e posaçme e njeriut bazuar në idetë e drejtësisë natyrore, realizimi i së cilës është i një rëndësie themelore për zhvillimin e demokracisë dhe parimit të sundimit të së drejtës. Standardi i Konventës për proces të rregullt përfshin një sërë të drejtash të posaçme, si e drejta për qasje efektive në gjykatë, e drejta për t'u dëgjuar, barazia në përdorimin e autoritetit të posaçëm, e drejta për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur e krijuar me ligj, e drejta për barazi në proces dhe të tjera.</p> <p>Një nga instrumentet për ushtrimin e së drejtës për qasje në drejtësi dhe standardin e procesit të rregullt është e drejta për ndihmë juridike. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore njih shprehimisht të drejtën për ndihmë juridike vetëm për individët e akuzuar për vepër penale, duke e përcaktuar këtë në nenin 6, paragrafi 3, pika (c), që sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës aplikohet drejtpërdrejt si pjesë e legjislacionit të brendshëm. Megjithatë, duke qenë se standardi i qasjes efektive në drejtësi dhe proces të rregullt aplikohet edhe në fushën e së drejtës civile, e drejta për</p> |



|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
|  |  |  | <p>ndihmë juridike garantohet edhe në rastet e të drejtave dhe detyrimeve në fushën civile.</p> <p>Sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, detyrimi për të ofruar ndihmë juridike falas ekziston kur këtë e diktojnë “interesat e drejtësisë”. Kriteret e përdorura si bazë për vlerësimin e “interesave të drejtësisë” janë zhvilluar në praktikën e gjatë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe janë shprehur në vendimet e saj të shumta. Në këtë aspekt, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 53 të saj, përcakton se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ, që i detyron gjykatat në Republikën e Kosovës të marrin parasysh praktikën gjyqësore të GJEDNJ gjatë vendosjes në raste të ngjashme në Kosovë. Në këtë aspekt roli kryesor i takon: kompleksitetit juridik dhe faktik të çështjes, ashpërsisë së dënimit të mundshëm, natyrës së të drejtës themelore që mbrohet në rastin konkret, si dhe rëndësisë së çështjes për individin, paaftësisë së supozuar të individit për ta mbrojtur veten sipas dispozitave të ligjit të brendshëm, aftësisë reale të individit për të qenë në gjendje të mbrohet, duke marrë parasysh moshën, si dhe të gjitha aktivitetet e tjera, si arsimimi, të qenët pjesëtar i grupeve të cenueshme ose të marginalizuara të shoqërisë, etj.</p> <p>Këshilli i Evropës ka dhënë udhëzime mbi ndihmën juridike për vendet anëtare përmes rezolutave dhe rekomandimeve të shumta për ta bërë qasjen efektive në drejtësi më të lehtë dhe më të sigurt, duke thjeshtuar dhe rritur transparencën e çështjeve gjyqësore, duke informuar publikun për mekanizmat e mbrojtjes ligjore, etj. Përveç kësaj, dokumentet e Këshillit të Evropës shprehin</p> |
|--|--|--|--|

|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
|  |  |  | <p>pritsmërinë që shtetet anëtare të rregullojnë ofrimin e ndihmës juridike ashtu që të sigurojnë që askush të mos parandalohet falë pengesave ekonomike dhe të tjera nga ushtrimi dhe mbrojtja e të drejtave të veta përpara çdo gjykate ose organi tjetër të autoriteteve publike.</p> <p>Dokumentet më domethënëse të Këshillit të Evropës në fushën e ndihmës juridike janë:</p> <p>Rezoluta (76) 5 për ndihmën juridike në çështje tregtare dhe administrative, Rezoluta (78) 8 për ndihmën dhe këshillat juridike, Rekomandimi nr. R (81) 7 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi masat që lehtësojnë qasjen në drejtësi, Rekomandimi nr. R (93) 1 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi qasjen efektive në ligj dhe drejtësi për personat shumë të varfër.</p> <p>Republika e Kosovës është e përkushtuar që të bëhet anëtare e plotë e BE-së dhe për këtë arsye është e nevojshme të rregullohet ofrimi i ndihmës juridike në përputhje me legjislacionin dhe standardet e BE-së në këtë fushë.</p> <p>Në BE, e drejta për ndihmë juridike përfaqëson një nga të drejtat themelore, ushtrimi i së cilës siguron qasje efektive në drejtësi. Karta e të Drejtave Themelore e BE-së e vitit 2000 parashikon që: “Çdo personi i jepet mundësia të këshillohet, të mbrohet dhe të përfaqësohet. Ndihma juridike u vihet në dispozicion atyre <u>të cilëve u mungojnë burimet e mjaftueshme</u> për aq sa ndihma e tillë është e nevojshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi” (neni 47, paragrafët 2 dhe 3).</p> |
|--|--|--|--|

|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
|  |  |  | <p><b>Direktiva e Këshillit 2000/43/KE, datë 29 Qershor 2000, mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht nga origjina racore ose etnike<sup>2</sup></b> inkurajon shtetet anëtare të përfshijnë organizatat e shoqërisë civile në ofrimin e ndihmës juridike kur shteti, për shkak të burimeve të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore, nuk është në gjendje të plotësojë kërkesat për ndihmë juridike falas.</p> <p>Direktiva e Këshillit 2002/8/KE, datë 27 janar 2003, për përmirësimin e qasjes në drejtësi në mosmarrëveshje ndërkufitare, duke vendosur rregullat minimale të përbashkëta lidhur me ndihmën juridike për mosmarrëveshjet e tilla, nga viti 2002<sup>3</sup> promovoi implementimin e ndihmës juridike në mosmarrëveshjet ndërkufitare për individët të cilëve u mungojnë burimet e mjaftueshme financiare për të bërë qasjen në drejtësi më të lehtë dhe më efektive.</p> <p>Vendimi Kuadër i Këshillit, datë 15 mars 2001, mbi pozitën e viktimave në procedimet penale, nga viti 2001<sup>4</sup> inkurajon vendet anëtare të sinkronizojnë të gjithë legjislacionin në mënyrë që të implementohet Rezoluta (76) 5 për ndihmën juridike në çështjet civile, tregtare dhe administrative, datë 18 shkurt 1976.</p> |
|--|--|--|--|

<sup>2</sup> Direktivë e Këshillit 2000/43/KE, datë 29 qershor 2000, mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht nga origjina racore ose etnike (Fletorja Zyrtare L 180, 19/07/2000 F. 0022 - 0026).

<sup>3</sup> Direktivë e Këshillit 2002/8/KE, datë 27 janar 2003, për përmirësimin e qasjes në drejtësi në mosmarrëveshjet ndërkufitare, duke vendosur rregullat minimale të përbashkëta lidhur me ndihmën juridike për mosmarrëveshjet e tilla. Fletorja Zyrtare L 26/41, 31/01/2003.

<sup>4</sup> 2001/220/DÇB: Vendimi Kuadër i Këshillit, datë 15 mars 2001, mbi gjendjen e viktimave në procedurë penale, Fletorja Zyrtare, L 82/1, 22/3/20 për implementimin e Strategjisë për përmirësimin e pozitës së romëve.

## 1.5. Pema e problemit

Problemi kryesor i identifikuar nga grupi punues është se gjendja aktuale e ndihmës juridike nuk është në përputhje me kërkesat e qytetarëve dhe i mungon zhvillimi dhe avancimi konform ndryshimeve të sistemit të drejtësisë. Ajo që është diskutuar nga grupi punues i referohet se gjendja aktuale nuk është e kënaqshme sa i përket qasjes në drejtësi përmes ndihmës juridike për të gjitha kategoritë shoqërore dhe kjo pjesë kërkon reflektim. Përpos kësaj është vërejtur se ka mos koordinim dhe shpërndarje në disa institucione unifikimi të ndihmës juridike dhe kjo ka ndikim edhe në efikasitet dhe sukses, andaj edhe kjo pjesë kërkon qasje reformuese. Pjesë me rëndësi është edhe cilësia e përfaqësimit profesional në rastet e ndihmës juridike, ku ka nevojë që të ketë ngritje dhe mbikëqyrje më të madhe sa i përket cilësisë së ndihmës juridike. Figura në vijim paraqet pemën e problemit të krijuar për qëllime të këtij Koncept Dokumenti.

Figura 8 - Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

|                         |   |
|-------------------------|---|
| <b>Efektet</b>          | Shpenzime të buxhetit të shtetit pa justifikime në mbulueshmëri dhe cilësi të ndihmës juridike falas  |
|                         | Mos përmbushje e nevojave të qytetarëve për ndihmë juridike falas   |
|                         | Cilësi jo e mjaftueshme e shërbimeve të ndihmës juridike falas  |
| <b>Problemi kryesor</b> | Mosfunksionimi i sistemit të ndihmës juridike falas dhe sfidat në përmbushjen e sasisë dhe cilësisë së shërbimeve të ndihmës juridike falas në Kosovë |
| <b>Shkaqet</b>          | Mungesa e një sistemi të konsoliduar dhe të qartësuar të ndihmës juridike falas   |
|                         | Kapacitetet dhe burimet e pamjaftueshme për të përmbushur Universin e Kërkesës për Ndihmë Juridike në Kosovë  |
|                         | Mungesa e mekanizmave të kontrollit të cilësisë të shërbimeve të ndihmës juridike falas   |

## 1.5.1. Shkaqet

Aktualisht tejet problematik është fakti se ekzistojnë tri institucione krejtësisht të ndryshme financimi për ndihmën juridike falas, siç u shtjellua më lartë.

Duke ekzistuar ndihma juridike falas në këta tre mekanizma institucional, fillimisht kjo krijon situatën që ndihma juridike mos të jetë e unifikuar në një mekanizëm institucional dhe këtë e ka lejuar shteti që të jetë e shpërndarë. Duke qenë e shpërndarë fillimisht është ngarkesë institucionale, pasi sipas këtij koncepti, sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial kanë edhe këtë kompetencë që nuk është drejtpërdrejt në fushëveprimin e tyre ndihma juridike falas. Rrjedhimisht, sistemi aktual nuk plotëson nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas, nuk ekzistojnë mekanizma të kontrollit të cilësisë së shërbimeve (përveç në ANJF), nuk ekziston një sistem i llogaridhënies së të gjithë pjesëve të sistemit dhe paraqet një kosto të papërbalueshme për shtetin. Për më tepër, kjo nënkupton që ka edhe shpërndarje të planifikimit, shpenzimit dhe raportimit për buxhetin që ju ndahet këtyre institucioneve e po ashtu krijon shumë vështirësi teknike dhe logjistike sa i përket buxhetit. Ajo që është me rëndësi për buxhetin, duke qenë i shpërndarë buxheti, nuk është efikas edhe sa i përket qasjes së barabartë nga qytetarët që kanë nevojë për ndihmë juridike nga shteti.

## 1.5.2. Efektet

Një sistem i ndihmës juridike që është jo-efikas dhe nuk funksionon mirë, mund të shkaktojë kosto të ndryshme indirekte, duke prekur individët, komunitetet dhe sistemin e përgjithshëm ligjor dhe të drejtësisë. Disa nga këto kosto indirekte përfshijnë sa vijon:

### 1. Kostot sociale:

- **Rritja e pabarazisë:** Mungesa e ndihmës juridike efektive mund të përkeqësojë pabarazitë sociale dhe ekonomike, pasi individët me burime të kufizuara financiare mund të kenë vështirësi për të realizuar qasje në përfaqësimin ligjor.
- **Pakënaqësi sociale:** Padrejtësia dhe jo-korrektësia e perceptuar që rezulton nga një sistem joadekuat i ndihmës juridike mund të kontribuojë në pakënaqësi sociale.

### 2. Kostot ekonomike:

- **Produktiviteti i humbur:** Çështjet ligjore që nuk trajtohen menjëherë dhe në mënyrë adekuate mund të çojnë në humbje të produktivitetit, pasi

individët mund të jenë të preokupuar me problemet e tyre ligjore në vend që të fokusohen në punë ose arsim.

- **Papunësia dhe varfëria:** Sfidat ligjore, veçanërisht ato që lidhen me punësimin ose strehimin, mund të kontribuojnë në papunësi dhe varfëri, duke i tendosur më tej sistemet e mbështetjes sociale.

### 3. **Kostot e sistemit të drejtësisë penale:**

- **Ngarkesa e rritur e lëndëve:** Ndihma e pamjaftueshme juridike mund të kontribuojë në rritjen e ngarkesës së lëndëve në sistemin e drejtësisë, pasi individët mund të mos kenë qasje në ndihmën juridike të nevojshme për t'u dalë mbanë proceseve ligjore ose për të adresuar çështjet themelore.
- **Rritja e jo-efikasitetit procedural:** Siç u shprehën shumë nga gjyqtarët penalë në Kosovë, lëndët me avokat mbrojtës janë më të lehta për t'u gjykuar, si dhe më të përshtatshme për zgjidhje në procedurë paraprake. Kur nuk ka avokat mbrojtës, gjyqtarët shpesh duhet ta marrin këtë rol në masë të caktuar.
- **Rritja e burgosjeve dhe mbipopullimi i burgjeve:** Të pandehurit pa avokat mbrojtës kanë më shumë gjasa të humbasin lëndët e tyre, duke rezultuar në burgosjen e më shumë personave sesa duhet. Burgjet në mbarë botën kushtojnë mjaft të shtrenjtë për t'u operuar.

### 4. **Kostot ligjore afatgjata:**

- **Përkallëzimi i problemeve ligjore:** Pa përfaqësimin e duhur ligjor, çështjet ligjore mund të përkallëzohen me kalimin e kohës, duke çuar në sfida ligjore më komplekse dhe më të kushtueshme (si paditë) në planin afatgjatë.

### 5. **Ndikimi në qasjen në drejtësi:**

- **Humbja e besimit në sistemin juridik:** Një sistem i ndihmës juridike që funksionon dobët mund të minoj besimin e publikut në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, duke i bërë individët më pak të prirë për të kërkuar drejtësi ose për të marrë pjesë në proceset ligjore.

### 6. **Sfidat e ndarjes së burimeve:**

- **Ndarja jo-efikase e burimeve:** Sistemet jo të plota të ndihmës juridike mund të rezultojnë në ndarje jo-efikase të burimeve brenda sistemit ligjor dhe të drejtësisë, pasi mund të ndodhë që lëndëve nuk u jepet prioritet për trajtim në bazë të rëndësisë ose urgjencës së tyre.

1. **Mos përmbushje të të Drejtave Themelore:** Ndihma juridike është thelbësore për të siguruar që të gjithë individët kanë qasje në drejtësi dhe për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të tyre. Pa këtë ndihmë, disa persona mund të mos jenë në gjendje të mbrojnë të drejtat e tyre ose të përballojnë sfidat ligjore.
2. **Impakti në Grupet e Margjinalizuara:** Grupet e marginalizuara dhe të varfëra janë veçanërisht të prekura nga mungesa e ndihmës juridike falas, pasi ato kanë më pak gjasa të kenë resurse për të paguar për këshillim juridik privat.

Sistemi aktual, mundëson poashtu që një avokat mos të jetë i angazhuar nga fillimi gjer në fund në një rast e në veçanti në çështje penale, kjo ka krijuar refleksion tek palët jo edhe aq të mirë, për faktin se ka pasur ndërrim të avokatëve dhe kjo është vërejtur se ka pasur raste kur cilësia e ofrimit të ndihmës juridike dhe cilësia së përfaqësimit nuk kanë qenë në nivelin e duhur.

Sa i përket ndihmës juridike dhe cilësisë së përfaqësimit, një pjesë që është identifikuar është edhe njoftimi i palës kohë pas kohe me statusin e lëndës së tyre në gjykatë. Palët e kanë vlerësuar se nga avokatët është e nevojshme që të ketë më shumë komunikim dhe njoftim për palët sa i përket statusit të lëndës dhe rrjedhën e zhvillimit të procedurës.

### 1.5.3.Palët e interesuara

Figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuar. Gjithashtu tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ato janë të prekura. Kapitulli 5 jep informacionin se si janë konsultuar këto palë të interesuara.

Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

| Emri i palës së interesuar                     | Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala  | Efekti-et me të cilat është e lidhur pala | Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)  |
|--|---|---|--|
| Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykatat       | <p>Numër i madh i kërkesave drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për ndihmë juridike penale falas (<i>sipas detyrës zyrtare</i>) që parashikohet në fazat gjyqësore (shqyrtuese) të procedimit penal.</p> <p>Ngarkesë për administratën në planifikimin buxhetor, shpenzimin dhe raportimin për ndihmë juridike penale falas (<i>sipas detyrës zyrtare</i>) që parashikohet në fazat gjyqësore (shqyrtuese) të procedimit penal.</p> |   | Shpërndarja e ndihmës juridike në disa mekanizma siç është aktualisht, ka refleksion në cilësinë e ndihmës juridike rrjedhimisht qasjes në drejtësi. |
| Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokuroritë | Numër i madh i kërkesave drejtuar Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për ndihmë juridike penale ( <i>sipas detyrës zyrtare</i> )  |   | Shpërndarja e ndihmës juridike në disa mekanizma siç është aktualisht, ka refleksion në cilësinë e ndihmës juridike rrjedhimisht qasjes në drejtësi. |



|   |  |  |   |
|---|--|--|---|
|   | <p>që ofrohet në fazat e hetimit pranë policisë dhe prokurorëve të shtetit.</p> <p>Ngarkesë për administratën në planifikimin buxhetor, shpenzimin dhe raportimin për ndihmë juridike penale falas (<i>sipas detyrës zyrtare</i>) që ofrohet në fazat e hetimit pranë policisë dhe prokurorëve të shtetit.</p> |  |   |
| Qeveria /Ministria e Drejtësisë organet e administratës publike | Mungesa e prioritizimit të ndihmës juridike rrjedhimisht qasjes në drejtësi për të gjitha kategoritë e shoqërisë   |  | Qasje reformatore dhe zhvillimore ndaj ndihmës juridike në relacion me reformat dhe zhvillimit të sistemit juridik në vend. |
| Agjencia për Ndihmë Juridike Falas                              | <p>Kapacitetet dhe burimet e pamjaftueshme</p> <p>Kërkesa të shumta për ndihmë juridike përtej mundësive që posedon</p>  |  |   |
| Oda e Avokatëve të Kosovës                                      | Cilësia e ofrimit të ndihmës juridike dhe cilësia e përfaqësimit   |  | Qasje jo e plotë në ofrimin e ndihmës juridike dhe përfaqësim.  |

|                                |  |  |  |
|--------------------------------|--|--|--|
| Organizatat e shoqërisë civile |  | Humbja e besimit të publikut   | Raportet e shoqërisë civile për monitorimin e gjyqësorit tregojnë mungesën e efikasitetit që tutje ndikojnë në humbjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. |
| Qytetarët                      |  | <p>Mosrealizimi i të drejtave në kohë të arsyeshme</p> <p>Humbja e besimit të publikut</p> <p>Qasja e kufizuar në drejtësi</p> | <p>Shkelja e të drejtave të njeriut.</p> <p>Numri i vogël i qytetarëve që përfitojnë nga ndihma juridike dhe përfaqësimi.</p>                                      |

## 1.6. Analiza krahasuese

### Lloji dhe efikasiteti i modeleve të realizimit të ndihmës juridike:

Lloji i modelit të realizimit të ndihmës juridike në një vend të caktuar ndikon shumë në sasinë, cilësinë dhe koston e ndihmës juridike. Së këndejmi, duhet të merret parasysh plotësisht në këtë vlerësim. Mëposhtë paraqitet një përshkrim i përgjithshëm krahasues i llojeve të ndryshme të modeleve që përdoren në mbarë botën dhe më pas do të shqyrtohen disa nga ato më të mundshmet për përdorim në Kosovë për të ofruar ndihmën juridike të financuar nga shteti. Janë vlerësuar mënyrat në të cilat këto modele mund të ndikojnë në volumin, cilësinë, koston e përgjithshme dhe efektivitetin relativ të koston. Dy aspektet e fundit (kosto dhe efektiviteti i koston relative) do të trajtohen nëpërmjet analizës kosto/përfitim të dy prej modeleve më të realizueshme.

**Modele të mundshme për realizimin e ndihmës juridike në çështje penale:** Ka një sërë modelesh të ndryshme ekzistuese që janë përdorur për të ofruar ndihmë juridike, qoftë më vete ose të kombinuara me të tjera, ku jo të gjitha janë të garantuara nga shteti apo të financuara nga shteti. Në përgjithësi, për ofrimin e ndihmës juridike, si në fushën civile/administrative ashtu edhe në atë penale, ekzistojnë modelet e mëposhtme:

- **Modeli i Mbrojtësit Publik ose Modeli i Ndihmës Juridike Institucionale (MMP)**, që ofron ndihmë juridike nëpërmjet një subjekti shtetëror, si zyra e mbrojtësit publik ose zyra e ndihmës juridike shtetërore, me “mbrojtës publikë” të dedikuar ekskluzivisht për ofrimin e ndihmës juridike me orar të plotë ose avokatë të ndihmës juridike në mënyrë institucionale. “Zyrtarët ligjorë” dhe struktura institucionale aktuale e ANJF në Kosovë është shembulli i këtij modeli;
- **Modeli kontraktues me OJQ/organizata private (MK)**, i ngjashëm me MMP në masën që mbështetet në avokatë me orar të plotë, të përkushtuar ekskluzivisht për ofrimin e ndihmës juridike, por përfshin dhënien e kontratave shtetërore organizatave të shoqërisë civile ose kompanive të sektorit privat/firmave të avokatisë për të ofruar shërbimet e ndihmës juridike në vend që ato të ofrohen drejtpërdrejt nga shteti. Ky model nuk është përdorur deri më sot në Kosovë;
- **Modeli i Mbrojtësit të Caktuar (MMC)**, që mbështetet në caktimin ose kërkesën (drejtuar një odë ose shoqate të avokatisë) për caktimin e avokatit privat nga gjyqtarët, policia, prokurorët ose aktorë të tjerë dhe pagesën e tarifës fikse për marrjen e lëndës, ose një skemë e bazuar në mekanizëm kompensimi për secilin veprim sipas një shkalle fikse. Në Kosovë, sistemi i ndihmës juridike në çështje penale me caktim *sipas detyrës zyrtare* në Kosovë dhe mekanizmi i ANJF për kontraktimin e avokatëve për t’i marrë lëndët gjyqësore përdorin modelin MMC.
- **Modeli vullnetar *pro-bono* (MVPB)**, që mbështetet në vullnetin e mirë të avokatëve për të marrë çështjet e ndihmës juridike pa asnjë kompensim. Në MVPB, avokatët privatë ofrojnë kohën dhe ekspertizën e tyre juridike për të ofruar shërbime juridike falas për individët nevojtarë. Komuniteti ligjor inkurajon avokatët të marrin vullnetarisht lëndë *pro bono*, duke kontribuar në qëllimin më të gjerë të rritjes së qasjes në drejtësi;

- **Modeli i detyruar *pro-bono* (MDPB)**, që mbështetet, për shembull, në detyrimin që avokatët e Odës të marrin përsipër numër të paracaktuar të lëndëve *pro bono* për të mbajtur anëtarësimin e tyre në Odë. Sipas këtij modeli, profesionistëve ligjorë u kërkohet me ligj ose rregullore profesionale që t'i kushtojnë një kohë të caktuar ofrimit të shërbimeve juridike *pro bono*. Aspekti i detyruar siguron kontribut të qëndrueshëm nga komuniteti ligjor për t'u shërbyer atyre që nuk mund të përballojnë shpenzimet e përfaqësimit ligjor. Sipas rregullativës së OAK-së, MDPB është detyrim për çdo avokat për një lëndë brenda vitit, por kjo nuk zbatohet në praktikë.
- **Modeli i Klinikës Juridike Universitare (MKJU)**, që mbështetet në punën e studentëve të drejtësisë të cilët marrin përsipër lëndë të thjeshta nën mbikëqyrjen e profesorit të tyre të drejtësisë. Sipas këtij modeli fakultetet apo universitetet juridike operojnë klinika juridike ku studentët e drejtësisë, nën mbikëqyrjen e stafit akademik dhe avokatëve të licencuar, ofrojnë ndihmë juridike për individët. Ky model i shërben qëllimit të dyfishtë të ofrimit të përvojës praktike për studentët e drejtësisë, duke shtrirë gjithashtu ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike për nevojtarët. Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "*Hasan Prishtina*" po e implementon këtë model në Kosovë me planifikimin për zgjerimin e tij;
- **Sistemi i ndihmës juridike:** Kombinim i dy ose më shumë modeleve të mësipërme që lidhet me standarde, praktika, burime financimi, mekanizma disiplinorë, trajnim, e kështu me radhë, të përbashkëta.

Secili model i përshkruar më sipër ka përparësi dhe mangësi, dhe efektiviteti i sistemit të ndihmës juridike shpesh varet nga kombinimi i këtyre modeleve për të adresuar nevojat e ndryshme ligjore të qytetarëve.

Për qëllimet e këtij Koncept Dokumenti, fokusi kryesisht do të jetë në dy nga modelet e mundshme, MMP dhe MMC, pasi këto të dyja modelet financohen përgjithësisht nga shteti dhe janë më të përdorurat nga shtetet në mbarë botën për të përmbushur detyrimet e tyre të ndihmës juridike sipas të drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare. Duhet theksuar se modeli MMC është në shumë mënyra i ngjashëm me modelin MMP me përjashtimin e rëndësishëm që në MMC ofruesi kryesor i ndihmës juridike është një OJQ ose subjekt privat dhe jo shteti, por shumë nga përparësitë dhe mangësitë e tjera të një modeli të tillë janë të ngjashëm me MMP. Në anën tjetër, MVPB, MDPB dhe MKJU janë të gjitha modele deri diku të kufizuara në kuptim të mbulimit dhe efektivitetit për arsye të ndryshme dhe janë më të përshtatshme si modele komplementare të modelit kryesor të ofrimit të shërbimeve dhe nuk do të diskutohen me shumë detaje këtu.

### **Analiza krahasuese e modeleve ekzistuese aktualisht në Evropë dhe vende tjera**

**Vendet me model të plotë ose të pjesshëm të mbrojtësit publik (MMP) kundrejt modelit të plotë të mbrojtësit të caktuar (MMC)**

- **Amerika:** Shtetet e Bashkuara (47 shtete MMP, 3 me MMC), Kanadaja, Meksika, Puerto Riko, Brazili, Argjentina, Paraguai, Kili, Kolumbia, Peru, Ekuadori, Nikaragua, Kosta Rika, Panamaja, Guatemala, El Salvador, Hondurasi, Bolivia, Uruguai
- **Evropë:** Anglia dhe Uells (pjesërisht), Skocia (pjesërisht), Irlanda (pjesërisht përmes Qendrave të Bordit të Ndhmës Juridike), Moldavia – përmes Zyrës për Ndhmë Juridike të Garantuar nga Shteti, Gjeorgjia – përmes Zyrës së Mbrojtësve Publikë, Finlanda (pjesërisht përmes avokatëve të Zyrës së Ndhmës Juridike të punësuar me orar të plotë), Bosnja dhe Hercegovina (përmes Qendrave të Ndhmës Juridike të MD), Belgjika (pjesërisht përmes Qendrave të Ndhmës Juridike), Armenia, Lituania (përmes Qendrave të Ndhmës Juridike), Republika Çeke (disa çështje civile) dhe Sllovakia (disa çështje civile).
- **Afrika, Azia dhe Oqeania:** Australia, Singapori, India, Pakistani, Nepali, Afrika e Jugut dhe Namibia.

**Vendet me kryesisht MMC:** Gjermania, Franca, Zvicra, Belgjikë, Holanda, Rumania, Ukraina, Irlanda (pjesërisht), Hungaria, Luksemburgu, Spanja dhe Portugalia.

## Kapitulli 2: Objektivat

Ministria e Drejtësisë në kuadër të Programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025, ka paraparë "Reformimin e sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative". Në këtë drejtim, te pjesa e Sundimit të ligjit në kuadër të nën-kapitullit 2.2 është përcaktuar hartimi i legjislacionit përkatës të nevojshëm për kompletim dhe ndryshim të politikave në fushën e ndihmës juridike falas. Andaj ky Koncept Dokument është në funksion të vlerësimit të gjendjes në fushën e ndihmës juridike falas dhe në kuadër të prioritetit strategjik 'drejtësi efektive', nën-qëllimi strategjik 9.1.1. Drejtësi me kohë, është paraparë hartimi i këtij Koncept Dokumenti.

*Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë*

| Objektivi relevant  | Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)  |
|---|--|
| Qëllimi strategjik – Reformimi dhe avancimi i sistemit të ndihmës juridike falas. | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025<br><br>Plani Kombëtar për Zhvillim<br><br>Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026<br>3.3. Qasja në drejtësi<br>Objektivi strategjik III: Fuqizimi i qasjes në drejtësi |
| Objektiva specifike –   | Sipas këtij Koncept Dokumenti.   |

|   |                                       |
|---|---------------------------------------|
| <p>Unifikimi i ndihmës juridike falas dhe buxhetit</p> <p>Plotësimi i nevojave të qytetarëve për ndihmë juridike falas duke ofruar shërbime të mjaftueshme dhe të qasshme të ndihmës juridike falas.</p> <p>Rritja e cilësisë së shërbimeve të ndihmës juridike falas për të siguruar që ato të përmbushin standardet e nevojshme dhe të mbështesin në mënyrë efektive qytetarët në nevojë.</p> |                                       |
| <p><i>Qëllimi i politikës –</i></p> <p>Unifikimi i ndihmës juridike falas në një mekanizëm institucional adekuat për trajtimin e kërkesave dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për qytetarët të cilët përmes ndihmës juridike realizojnë qasje në drejtësi.</p>  | <p>Sipas këtij Koncept Dokumenti.</p> |

### Kapitulli 3: Opsionet e shqyrtuara

Bazuar në analizën e problemit më lartë dhe objektivat që synohen të arrihen, grupi punues ka shqyrtuar gjithsej tri opsione.

#### Kapitulli 3.1: Opsioni i parë - pa asnjë ndryshim

Pavarësisht vlerësimit të realizuar dhe raporteve për fushën ndihmës juridike falas, legjislacioni përkatës në fuqi nuk ndryshon me qëllim të ndryshimit të gjendjes aktuale. Nga mos ndryshimi përkatësisht ndryshimit të legjislacionit përkatës, gjendja do të vazhdon të jetë e njëjtë dhe pa ndonjë ndryshim dhe reformë përmes së cilave do të rezultojë në avancimin dhe ngritjen e fushës së ndihmës juridike falas në nivel më të lartë nga ai që është për momentin. Mos ndryshimi i legjislacionit përkatës në fuqi që i referohet ndihmës juridike falas, do të mundëson që të vazhdohet me gjendjen aktuale përkatësisht të njëjtë dhe atë si në vijime, ku:

- Burimet njerëzore në Agjenci do të jenë të pamjaftueshëm me mungesë të mjaftueshme buxhetore e të cilat kanë refleksion në sasinë dhe në cilësinë e shërbimeve të ndihmës juridike falas;
- Legjislacioni përkatës aktual për Ndihmën Juridike Falas i referohet rregullimit të aspektit organizativ të ndihmës juridike falas. Nuk është më në detaje e trajtuar çështja e ofrimit të ndihmës juridike falas.

- Mekanizmi përkatës për monitorimin e vlerësimit të cilësisë së ndihmës juridike falas nuk është aktiv edhe për kundër faktit se është me rendësi pasi mundësinë që të ketë refleksion në cilësinë e ndihmës juridike falas;
- Do të vazhdohet me paqartësitë sa i përket formulës së financimit për shërbimet e ndihmës juridike falas;
- Do të vazhdohet me gjendjen aktuale ku pozita e përgjithshme e zyrtarëve në Agjenci, nuk do të përkon me detyrat dhe përgjegjësitë që kryen, të cilët kanë përgjegjësi deri diku të ngjashme me avokaturën e shtetit;
- Mungon instrumenti dhe kapacitetet e nevojshme për monitorim të shërbimeve që ofrohen, sidomos pjesën e avokatisë;
- Te personeli, dominon profili i juristit, përderisa konstatohet mungesë dhe nevojë e madhe e atyre që kanë të përfunduar provimin e jurisprudencës, por pagat e ulëta ndikojnë në mos interesimin e tyre për tu bërë pjesë e Agjencisë;
- Infrastruktura jo adekuate, mungesa e hapësirave të mjaftueshme dhe e qasjes së lehtë për personat në nevojë për shërbimet e ndihmës juridike falas;
- Mungesa e automjeteve, inventarit dhe pajisjeve të mjaftueshme punës për të realizuar detyrat dhe përmbushur përgjegjësitë;
- Mungesa e fondeve të mjaftueshme dhe bartja e detyrimeve të pa paguara nga një vit në vitin tjetër;
- Organogrami i Agjencisë mbetet jo mirë i definuar dhe kërkon revidim dhe strukturim të qartë, si dhe përshkrimi i saktë i detyrave dhe obligimeve të punës për Drejtorin, Udhëheqësit, si dhe për zyrtarët që ofrojnë shërbimeve të ndihmës juridike falas dhe pjesa e stafit administrativ;
- Nuk ka një vlerësim për specifikimin e mirëfilltë të shërbimeve dhe nevojave për ndihmë juridike falas, se cilat shërbime do të ofrohen nga Agjencia dhe cilat shërbime do të kontrahohen përmes angazhimit të avokatëve sipas procedurave të parapara me ligj;
- Mungojnë trajnime të mjaftueshme, për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të Agjencisë të cilët merren me ofrimin e ndihmës juridike falas;
- Agjencia ka një sistem funksional për mbledhjen e të dhënave lidhur me përfituesit ndihmës juridike falas dhe shërbimet e ofruara, për të cilat ka edhe raportime në intervale të rregullta. Megjithatë, mungesa e koordinimit ndër institucional me institucionet e pavarura kushtetuese dhe jo sa duhet edhe me Shoqërinë Civile, ndikon në mos-përditësimin real dhe rregullt me të dhënat e tyre, gjë e cila paraqitet si problem.

## Kapitulli 3.2 Opsioni i dytë - i ndërmjetëm (Modeli Hibrid)

### **i. Përmirësimi i kapaciteteve për të përmbushur Universin e Kërkesës për Ndihmë Juridike në Kosovë:**

Për një numër arsyesh, mund të jetë e nevojshme të mendohet për përdorimin e një modeli hibrid të përzier, që është t MMP si dhe MMC sipas parametrave si në vijim:

- Të fillohet zbatimi i modelit të përfaqësimit në seanca gjyqësore nga zyrtarët e ANJF-së, në procedurë civile, administrative dhe penale. Përfaqësimi në procedura civile dhe administrative duhet të parashihet që gradualisht të mbulohet në tërësi nga zyrtarët e ANJF-së. Ndërsa sa i përket raste penale, siç ndodh shpesh me inicimin e nismave të tilla, do të ishte e rekomandueshme që fillimi i zbatimit të një modeli të tillë për përfaqësimet penale të fillohej të zbatohet në Prishtinë me të paktën tre zyrtarë, për shembull, e cila ka shumicën e rasteve në vend. Pjesa e rasteve të përfaqësimeve penale e cila nuk mund të mbulohet nga zyrtarët për shkak të volumit të punëve, ANJF do të angazhonte avokatë sipas listës së avokatëve të OAK-së. Rekomandohet të fillojë zbatimi i këtij modeli në Prishtinë dhe më pas përdorimi i tjetrit si grup "kontrolli" për të matur ndikimin e funksionimit ose jo këtij modeli. Fillimi i këtij modeli duhet të shoqërohet nga implementimi i një softueri të thjeshtë jashtë raftit për të qenë në gjendje të monitorohet në mënyrë efektive MMP-në dhe ndikimin i tij, duke përfshirë nivelin e kënaqësisë së klientëve. Angazhimi i avokatëve të OAK-së duhet të parashihet edhe për përfaqësim në procedura civile dhe administrative në rast të volumit të papërbalueshëm të punëve, por që ANJF duhet të tentojë që këto raste t'i mbulojë parimisht me zyrtarët e saj.
- Unifikimi i pjesës së Ndhmës Juridike Falas nga KGJK për ndihmë juridike penale falas (*ex-officio* ose *sipas detyrës zyrtare*), ajo e KPK-së dhe Agjencia për Ndhmë Juridike Falas në një mekanizëm të vetëm dhe atë në Agjencinë për Ndhmë Juridike falas. Një unifikim i tillë do të jetë në funksion të planifikimit, realizimit më të mirë të ndihmës juridike falas, si dhe rrjedhimisht do të ketë refleksion edhe në arsyeshmërinë e buxhetit përball rasteve që do tu ofrohet ndihmë juridike falas;
- Bartjen e buxhetit nga KGJK, KPK në ANJF të asaj pjese që gjerë me tani ka qenë e ndarë te këto dy mekanizma institucional. Kjo do të mundësonte që për ndihmën juridike falas buxheti i ndarë nga shteti të jetë i koncentruar vetëm në ANJF dhe nga kjo e fundit të planifikohet, alokohet, shpenzohet dhe të raportohet. Kjo formë do të ketë refleksion më të mirë në planifikimin e buxhetit, shpenzimin dhe raportimin, përpos këtyre do të jetë e mundur që të ketë numër më të madh të atyre që do tu ofrohet ndihmë juridike falas;
- Për zyrtarët e ANJF, do të përcaktohen kushtet e punës konform përgjegjësive dhe përgatitjes akademike dhe profesionale që ata kanë. Përkatësisht do të përcaktohet grada e tyre rrjedhimisht paga sipas Ligjit të Pagave. Mirëpo kushtet e punës përkatësisht paga e tyre do të pasqyrojnë përgjegjësinë, rëndësinë e tyre që kanë në ofrimin e ndihmës juridike falas dhe cilësisë së tyre që vetë këta zyrtar do të ofrojnë ndihmë juridike dhe përfaqësim në gjykatë dhe organ administrative.
- Përfaqësimi në lëndët penale të bëhet në kombinim nga zyrtarët e ANJF-së siç është shtjelluar më lartë dhe sipas sistemit aktual të *ex officio* që nënkupton



kontraktimin e avokatëve të OAK-së. Megjithatë, kontraktimi do të bëhet nga ANJF pas reformave për konsolidimin e ndihmës juridike falas në ANJF të propozuara më poshtë.

- Përcaktim ligjor duhet të vendos kushtin për dhënien e provimit të jurisprudencës dhe përvoja profesionale juridike që duhet të plotësojnë Zyrtarët e ANJF-së. Kjo do të siguron që rastet e ndihmës juridike falas do të trajtohen, përfaqësohen duke u bazuar në profesionalizëm, përgjegjësi dhe përkushtim, parakushte të cilësisë së mirë të ofrimit të ndihmës juridike falas nga zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.
- KPP të ndryshoj për të eliminuar dallimin midis rasteve të “mbrojtjes së detyrueshme” dhe “mbrojtjes jo të detyrueshme” në lidhje me disponueshmërinë e ndihmës juridike . Kjo do të eliminonte dhënien e ndihmës juridike, për shembull, personave të aftë financiarisht në rastet e mbrojtjes së detyrueshme, gjë që nuk është një përdorim i mirë i burimeve jashtëzakonisht të kufizuara të disponueshme për ndihmë juridike falas. Kjo do të inkurajonte gjithashtu gjyqtarët, të cilët në pjesën më të madhe caktojnë ndihmë juridike vetëm në rastet e mbrojtjes së detyrueshme, për të zgjeruar disponueshmërinë e ndihmës juridike. Kushdo që përballet me burgim (d.m.th., pothuajse në çdo çështje penale) do të kishte të drejtën e ndihmës juridike nëse ai ose ajo plotëson testin e nevojave. Ashtu si në shumë vende të tjera në mbarë botën, nëse një i pandehur i cili është financiarisht i aftë të kontraktojë një avokat nuk dëshiron ta bëjë këtë, ai ose ajo duhet të lejohet të vazhdojë të mbrojë veten. Në këto raste, gjyqtarët duhet të zhvillojnë një seancë për të përcaktuar se i pandehuri ka një “grykim të shëndoshë” në marrjen e vendimit për të proceduar pa përfaqësim profesional. KPP të ndryshoj gjithashtu për të mundësuar përfaqësimin në rastet penale gjithashtu nga zyrtarët e ANJF-së të cilët plotësojnë kriteret për të qenë avokatë.
- Është i nevojshëm poashtu një specifikim më i detajuar i kriterëve për ndihmë juridike falas, në mënyrë që të ketë një aplikim uniform të vlerësimit të kriterëve. Ngjashëm, lista e grupeve specifike e normuar taksativisht në legjislacionin aktual, është vlerësuar të jetë përjashtuese për kategorinë e viktimave të luftës. Andaj, është e nevojshme që të përfshihet edhe kjo kategori, por duke mos u kufizuar vetëm në këtë grup.
- Në lidhje me vlerësimin e kriterëve dhe llojeve të ndihmës juridike primare dhe sekondare, janë paraqitur gjithashtu probleme në praktikë, siç është përmendur më lartë. Sipas ligjit aktual, të dyja llojet e ndihmës juridike kanë për qëllim të sigurojnë që individët që kanë nevojë për ndihmë juridike të kenë qasje në informata, këshilla dhe përfaqësim ligjor. Për të adresuar këto probleme dhe për

të siguruar një ndarje më të qartë, propozohen ndryshimet e mëposhtme në Ligjin për Ndhimë Juridike Falas:

- Ndhimë Juridike Primare:
  - Të përfshijë vetëm informata dhe këshilla juridike lidhur me procedurat ligjore.
  - Ky shërbim të jetë i disponueshëm për të gjithë personat që kualifikohen sipas kriterëve të përcaktuara.
- Ndhimë Juridike Sekondare:
  - Të përfshijë informata, këshilla juridike, përpilimin e shkresave dhe tërë ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës.
  - Të përfshijë përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.
  - Ky shërbim të jetë i disponueshëm për personat që kualifikohen sipas kriterëve të përcaktuara dhe kanë nevojë për mbrojtje dhe përfaqësim të plotë ligjor.
- Promovimi i një kulture pro bono në mesin e avokatëve përmes zbatimit të detyrimit për ofrimin e shërbimeve pro bono, të paraparë nga rregulloret përkatëse që burojnë nga Ligji për Ndhimë Juridike Falas.
- Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-së) dhe klinikat ligjore luajnë një rol kyç në plotësimin e kërkesës për ndihmë ligjore, veçanërisht për komunitetet e marginalizuara dhe të ndjeshme. Këto entitete mbushin boshllëkun e ndihmës juridike të ofruar nga shteti, duke siguruar që qasja në drejtësi të mos jetë një privilegj, por një të drejtë për të gjithë. OShC-të, përmes programeve të edukimit ligjor dhe ndihmës direkte juridike, fuqizojnë individët me njohuri dhe mjete të nevojshme për të naviguar në sistemin ligjor. OShC që operojnë në fushën e ndihmës juridike falas, ofrojnë përvojë praktike dhe të drejtpërdrejtë ligjore për të punësuarit, ndërkohë që ofrojnë shërbime juridike falas për ata që kanë nevojë. Kjo marrëdhënie simbolike jo vetëm që rrit gjeneratën e ardhshme të profesionistëve ligjorë me një ndjenjë të fortë të përgjegjësisë sociale, por gjithashtu siguron që grupet e ndjeshme, siç janë komunitetet etnike, gratë dhe të varfrit, të marrin mbështetjen ligjore që u nevojitet. Në Ligjin e ri do të të përcaktohen qartë mënyra e ofrimit të shërbimeve juridike nga OShC dhe kriteret që duhen plotësuar për të ofruar ndihmë juridike falas.
- Gjithashtu, Ligji i ri do të parasheh një kornizë formale e kontraktimit që u lejon OShC-ve të konkurrojnë për fonde për të ofruar shërbime specifike juridike. Kjo

qasje jo vetëm siguron transparencë dhe llogaridhënie, por edhe promovon efikasitet në ofrimin e shërbimeve.

- Në kuadër të kësaj reforme, dhe avancimit të ndihmës juridike falas, pjesë me rëndësi është edhe përcaktimi i bazës ligjore të themelimit, funksionimit dhe bashkëpunimit të Klinikave Juridike të Ndihmës Juridike në kuadër të fakulteteve Juridike të universiteteve dhe kolegjeve në Kosovë. Duke i inkorporuar Klinikat Juridike të Ndihmës Juridike Falas, fillimisht do të ketë më shumë informim, qasje dhe pranim të shërbimeve për ndihmën juridike falas nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Andaj kjo pjesë është e rëndësishme për reformimin dhe avancimin e ndihmës juridike falas në vend;
- Përcaktim ligjor dhe konstituiv për mekanizmin në kuadër të ANJF sa i përket mbikëqyrjes së shërbimeve të ndihmës juridike falas dhe përfaqësimit në organet kompetente, është gjithsesi i nevojshëm. Këtu referenca bëhet në atë që avokatet vetëm janë të kontraktuar nga Agjencia, por përgjegjës për disiplinë dhe etikë janë ndaj Odes së Avokatëve. Pavarësisht kësaj, përkatësisht me dispozita përkatëse ligjore duhet të konstituohet dhe qartësohet ky mekanizëm, duke përfshirë kompetencat si dhe ndërveprimin në mes të ANJF-së dhe OAK-së;

## **ii. Përmirësimi i cilësisë së ndihmës juridike të financuar nga shteti në Kosovë**

- Miratimi i parimeve të drejtësisë me në qendër qytetarin, gjatë ofrimit të shërbimeve. Kjo përfshin kryerjen e anketave periodike të kënaqëshmërisë së klientit. Gjithashtu përfshin adoptimin e një qasjeje shumë disiplinore, e cila përfshin përdorimin e punonjësve socialë dhe psikologëve për të mbështetur klientët dhe për të ofruar të dhëna në aspektet psikologjike të rasteve komplekse.
- Ligji i ri do të parasheh standarde etike për të garantuar cilësinë e lartë të ndihmës juridike në të gjitha fushat (siç ka bërë ANJF tanimë në fushën e së drejtës civile dhe administrative), që do të respektohen nga ofruesit. Përfshirja e avokatëve në mekanizmat kontraktues (në përfaqësimet *ex-officio*) është një mënyrë efektive për t'i bërë ata përgjegjës për respektimin e tyre. Kryerja e auditimeve periodike ose rishikimeve të performancës, bazuar në ekzaminimin e dosjeve të rasteve të zgjedhura rastësisht, është një mënyrë efektive për të zbatuar këto standarde. Varësia e prokurimit të kontratave shtesë ose rasteve të ardhshme nga mospasja e ndonjë çështjeje disiplinore në vazhdim, është një mënyrë tjetër e mirë për të nxitur respektimin e standardeve etike ose praktike;
- Fokusi në cilësinë e shërbimeve ligjore, duke kategorizuar avokatët bazuar në përvojën e tyre për të përfaqësuar në çështjet ligjore sipas kompleksitetit të rasteve. Duhet të parashihet rregullim i tillë i cili obligon OAK-në që listat e avokatëve t'i dorëzojë ANJF-së të kategorizuara sipas përvojës dhe lëmisë juridike që avokatët deklarohen si të gatshëm të përfaqësojnë.

- Ligji i ri do të parasheh gjithashtu qasjen e nevojshme dhe e kontrolluar e ANJF-së në baza të të dhënave në Gjykatë dhe Prokurori, me qëllim të lehtësimit të komunikimit dhe njoftimit të Agjencisë me Gjykatat për lëndë konkrete. Kjo do të mundësonte që të ketë përparësi njoftimi dhe komunikimi elektronik ndërmjet Gjykatës, Prokurorisë dhe ANJF-së duke mundësuar eliminim të shpenzimeve të komunikimit me Postë, kohë më të shkurtër, efikasitet më të lartë.

### **Përparësitë dhe mangësitë e Opsionit të dytë:**

#### **1. Përmirësimi i Qasjes në Ndhimë Juridike Falas:**

- Modeli hibrid lejon një qasje më fleksibël dhe të përshtatshme për të ofruar ndihmë juridike, duke u përshtatur me nevojat e ndryshme rajonale dhe duke lejuar një qasje të testuar për implementim të mëtejshëm.

#### **2. Efikasiteti dhe Koordinimi i Burimeve:**

- Unifikimi i buxhetit dhe resurseve në një agjenci të vetme rrit efikasitetin e planifikimit, shpërndarjes dhe monitorimit të fondeve për ndihmën juridike falas.

#### **3. Rritja e Profesionalizmit dhe Cilësisë së Shërbimit:**

- Përcaktimi i kriterëve të qarta për zyrtarët e ndihmës juridike dhe avokatët përmes kërkesave për provimin e jurisprudencës dhe përvojës profesionale siguron që rastet të trajtohen me një nivel të lartë profesionalizmi dhe përkushtimi.

#### **4. Nxitja e Kulturës Pro Bono:**

- Promovimi i angazhimit pro bono në mesin e avokatëve ndihmon në zgjerimin e qasjes në ndihmë juridike për ato kategori të popullsisë që kanë më së shumti nevojë.

#### **5. Forcimi i Rolit të Organizatave të Shoqërisë Civile:**

- Përfshirja e OShC-ve dhe klinikave ligjore në ofrimin e ndihmës juridike falas plotëson boshllëqet në shërbimet e ofruara nga shteti dhe rrit qasjen për grupet e marginalizuara.

### **Mangësitë e Opsionit të Dytë - të Ndërmjetëm**

#### **1. Kompleksiteti dhe Sfidat e Implementimit:**

- Modeli hibrid mund të sjellë sfida në implementimin dhe koordinimin e tij, veçanërisht në fazat fillestare, ku nevojiten përpjekje të mëdha për trajnim dhe adaptim.

#### **2. Rreziku i Mospërputhjeve dhe Konfuzionit të Kompetencave:**

- Bashkimi i burimeve dhe përgjegjësi mund të sjellë mospërputhje në kompetencat dhe detyrat e institucioneve të ndryshme të përfshira, duke kërkuar një menaxhim të kujdesshëm të tranzicionit.

#### **3. Nevoja për Burime Shtesë Financiare dhe Njerëzore:**

- Modeli i ndërmjetëm, pavarësisht synimeve për të përmirësuar qasjen dhe cilësinë e ndihmës juridike falas, rrezikon të ruajë status quo në raport me alokimin e buxhetit dhe menaxhimin e resurseve. Ky model mund, edhe pse sjellë ndryshime të mjaftueshme strukturore që adresojnë sfidat ekzistuese sa i përket kontrollit të cilësisë dhe menaxhimit të ndihmës juridike falas, të çojë në një situatë ku përpjekjet për të zgjeruar dhe përmirësuar shërbimet mund të kompensohen nga koston e lartë operacionale. Si rezultat, ekziston një rrezik real që modeli i ndërmjetëm, në përpjekjen për të balancuar ndërmjet inovacionit dhe zbatimit praktik, mund të rezultojë në një sistem më të shtrenjtë se modeli aktual.

#### 4. Sfidat në Ruajtjen e Standardit të Shërbimeve:

- Përbajtja e një standardi të lartë të shërbimit nëpër ndryshime dhe zgjerime të sistemit të ndihmës juridike mund të jetë sfiduese, duke kërkuar mekanizma të fortë mbikëqyrëse dhe vlerësim të vazhdueshëm të cilësisë.

### Kapitulli 3.3 Opsioni i tretë- Sistemi i Pastër i Mbrojtësve Publik i. Përmirësimi i kapaciteteve për të përmbushur tërësinë e Kërkesave për Ndihmë Juridike në Kosovë:

Siç u parashtrua më lartë në më shumë detaje, mangësitë e mëposhtme ekzistojnë në ofrimin e llojeve të mëposhtme të ndihmës juridike. Vërehet se në raste të caktuara ka qenë e pamundur të nxjerrën të dhëna të veçanta, siç është shpjeguar më lartë. Të gjitha shifrat janë vjetore (duke përdorur vitin 2022 si vitin bazë për të bërë llogaritjet siç përshkruhet më sipër):

| Lloji i ndihmës juridike               | Universi | Hendeku i vlerësuar (nr. dhe %) |
|--|----------|---------------------------------|
| Penale (primare sipas detyrës zyrtare) |          |                                 |
| • Standardi KPP                        | 6,072    | 4,139 (68%)                     |
| • ANJF ose Stand. Ndërk.               | 4,489    | 2,556 (47%)                     |
| Penale (sekondare nga ANJF)            | UTD      | UTD                             |
| Civile (primare nga ANJF/OAK)          | 9,453    | 8,948 (95%)                     |
| Civile (sekondare nga ANJF)            | UTD      | Minimal                         |
| Admin. (primare nga ANJF/OAK)          | 1,458    | 1,439 (98.7%)                   |
| Admin. (sekondare nga ANJF)            | UTD      | Minimal                         |

Në përputhje me këto gjetje, janë zhvilluar rekomandimet e mëposhtme për të rritur volumin e ndihmës juridike të ofruar në Kosovë sa i përket këtij opsioni. Rritja e volumit të ndihmës juridike mund të bëhet në mënyra të ndryshme:

Konsiderohet ndryshimi i modelit të ofrimit të shërbimeve juridike që po përdoren, veçanërisht për ndihmën juridike parësore (përfaqësimi në gjykatë). Modeli aktual, si në ANJF ashtu edhe në sistemin *ex officio* është "Modeli i Avokatit të Caktuar" ose MAC, i cili mbështetet në caktimin e përkohshëm të çështjeve avokatëve privatë të OAK-së nëpërmjet pagesave të bazuara ose në bazë aktiviteti për aktivitet me një total (ANJF) ose një tavan mujor (*ex officio*). Më sipër është paraqitur një analizë e kosto/përfitimit të përdorimit të një MMC kundrejt një MMP për secilin nga llojet e ndryshme të ndihmës juridike. Siç mund të shihet në analizën kosto/përfitim, modeli ONJI, në dritën e rrethanave në Kosovë (përkatësisht paga relativisht të ulëta për punonjësit e stafit me orar të plotë dhe fakti që ANJF tashmë ka zyrë dhe infrastrukturë të konsiderueshme logjistike në vend për të qenë në gjendje të miratojë ONJI me kosto relativisht të ulëta. Janë kryer disa llogaritje të ndryshme për të treguar efikasitetin relativ të koston së secilit model në skenarë të ndryshëm. Këto mund të përmbliidhen si më poshtë:

#### **Kostot relative "për rast" duke përdorur modelet e propozuara MMP:**

- Penale (faza gjyqësore):
  - o Rastet e detyrueshme të mbrojtjes (të rënda): 138 € (34% e koston së MMC)
  - o Rastet e mbrojtjes jo të detyrueshme (mesatarisht të rënda): 81€ (20% e koston së MMC)
  - o Rastet më pak të rënda: 45 € (11% e koston MMC)
- Civile: 103 € (54% e koston MMC)
- Administrative: 46 € (24% e koston MMC)

#### **Kostot relative të MMP për të prodhuar sasinë aktuale të ndihmës juridike të ofruar sipas modeleve MMC:**

##### **Përdorimi i modeleve MMC:**

- Penale (faza gjyqësore): 1,933 (1,643 raste të rënda dhe 290 mesatarisht të rënda) me kosto totale prej 797,991 €
- Civile: 505 lëndë me kosto totale prej 96,960 €
- Administrative: 19 lëndë me kosto totale prej 3,648 €

##### **Përdorimi i modeleve MMP:**

- Penale (faza gjyqësore): 1,933 raste me kosto prej 250,224 € (31% e koston ACM)
  - o Rastet e detyrueshme të mbrojtjes (të rënda) (1,643 raste): 226,734
  - o Rastet e mbrojtjes jo të detyrueshme (mesatarisht të rënda) (290 raste): 23,490
- Civil: 505 raste me 52,015 € (54% e koston MMC)
- Administrative: 19 raste me kosto totale prej 874 € (24% e koston MMC)

## **Kostot relative të MMP për të përmbushur "universin e nevojës":**

### **Përdorimi i MMP-ve:**

- ANJF MMP (duke përdorur kriteret e pranueshmërisë KPP) - **948,115,92 €** (21% e kostos MMC)
- ANJF MMP (duke përdorur Ligjin e Ndhmës Juridike ose kriteret e pranueshmërisë së ligjit ndërkombëtar) - **280,252,80 €** (7% e kostos ACM)
- Çështjet civile të ANJF MMP - **928,796.90 €** (54% e kostos MMC)
- Çështjet e së drejtës administrative ANJF MMP - **67,370 €** ( 24% e kostos MMC)

Në këtë Opsion gjithashtu vlen ndryshimi i sugjeruar në KPP për të eliminuar dallimin midis rasteve të "mbrojtjes së detyrueshme" dhe "mbrojtjes jo të detyrueshme" në lidhje me disponueshmërinë e ndihmës juridike.

### **Përmirësimi i cilësisë së ndihmës juridike të financuar nga shteti në Kosovë**

Koncepti dokumenti zbuloi se cilësia e ndihmës juridike të ofruar ndryshonte në varësi të llojit të ndihmës juridike të ofruar varësisht se nga kush ofrohet (OAK, KGJK, KPK ose ANJF).

Në fushën e së drejtës penale, ku ofruesi kryesor është OAK përmes sistemit *ex officio* të paguar nga KPK ose KGJK, varësisht nga aktori i sektorit të drejtësisë që kërkon caktimin, shqyrtimi është i përzier. Në sondazhin e OSBE-së për Ndhmën Juridike me qindra gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë privatë (i kryer në vitin 2020), 40% e gjyqtarëve dhe prokurorëve shprehën shqetësimet "shpesh" ose "shumë shpesh" për cilësinë dhe shumë pretenduan se ndihma juridike ofrohet shpesh thjesht në mënyrë "formale" dhe jo shumë substanciale apo teknike, por kishte përjashtime dhe disa, duke përfshirë disa anëtarë të Grupit Punues të Koncept Dokumentit, shprehën mendimin e tyre se ndihma juridike *ex officio* ishte e një cilësie të pranueshme dhe se mund të përmirësohet me disa rregullime, si krijimi i një mekanizmi të kontrollit të cilësisë, zbatimi i trajnimeve të specializuara dhe sigurimi që çështjet komplekse të mos caktohen për avokatë të rinj ose të papërvojë, por edhe miratimi i mekanizmave për të garantuar vertikalishtet e përfaqësimit (d.m.th. i njëjti mbrojtës gjatë gjithë kohës në gjithë procedurën). Sipas të gjitha pyetjeve gjatë vlerësimit, sistemi *ex officio* nuk ka një sistem institucional të kontrollit të cilësisë (përveç mekanizmit disiplinor të OAK-së, i cili asnjëherë nuk është ushtruar në emër të keqpërdorimit apo neglizhencës në një rast *ex officio*). Ka pak ose nuk ka fare specializim të avokatëve *ex officio*. Lëndët caktohen në mënyrë të rastësishme dhe jo sipas përvojës, kështu që avokatëve të rinj mund t'u caktohen çështje shumë komplekse, gjë që dukshëm ndikon në cilësinë e përfaqësimit.

Gjatë hartimit të këtij Koncept Dokumenti nuk ka qenë e mundur të merren informacioni shumë mjaftueshëm specifik për të bërë një vlerësim të mjaftueshëm të ndihmës juridike

shumë të kufizuar penale të ofruar nga ANJF, përveç gjetjeve të përgjithshme në lidhje me programin e ANJF-së për të caktuar avokatë dhe pagesën e tyre sipas veprimtarisë si në çështjet e së drejtës civile dhe administrative (të cilat janë të përcaktuara më poshtë).

Në fushën civile dhe administrative të mbuluar nga ANJF (e cila përfshin gjithashtu një numër shumë të kufizuar të rasteve penale dhe kundërvajtëse), ekzistojnë dy situata të ndryshme siç është përmendur më lartë. Njëra është ndihma juridike e ofruar nga zyrtarët ligjor të ANJF-së dhe tjetra ndihma juridike e ofruar përmes përfaqësimit nga avokatët e angazhuar. Ndërsa standardi i cilësisë rezultoi të ishte mjaft i lartë me shumë pak ankesa në lidhje me ndihmën juridike e ofruar nga zyrtarët e ANJF-së, u raportuan disa probleme me ndihmën juridike të ofruar përmes modelit të avokatit të caktuar nga ANJF, duke përfshirë kryesisht lëshime në lidhje me komunikimin me klientët dhe duke mos i mbajtur ata të informuar se çfarë po ndodhte në rastet e tyre, cilat janë të drejtat e tyre dhe çfarë të presin me rastet e tyre.

Si të tilla, rekomandimet lidhur me atë se si të përmirësohet cilësia e ndihmës juridike në Kosovë, sipas këtij Opsioni, përfshijnë si në vijim:

- Ashtu si me rritjen e sasisë së ndihmës juridike në Kosovë me një kosto të përbalueshme, opsioni i tretë rekomandon që i gjithë sistemi i ndihmës juridike të lëvizë drejt përdorimit të modelit të mbrojtësit publik/ofruesit të ndihmës juridike institucionale (MMP). Ky është veçanërisht rekomandimi në fushën civile dhe administrative, por edhe në fushën penale. Siç u tha më lartë, MMP ka disa karakteristika që mund të rezultojnë në cilësi më të lartë, duke përfshirë: krijimin dhe funksionimin më të lehtë të një njësie institucionale të kontrollit të cilësisë; organizimi i trajnimit të përbashkët të të gjithë mbrojtësve publikë/ofruesve të ndihmës juridike me kohë të plotë; vertikalishtetë e përfaqësimit; ekonomitë e shkallës që e bëjnë atë me kosto shumë efektive; adoptimi i një qasjeje ekipore e cila është më holistike dhe integrale; maksimizimi i burimeve njerëzore duke i bërë anëtarët e ekipit të specializohen në atë për të cilën janë trajnuar (d.m.th. avokatët mbrojnë dhe përfaqësojnë klientët në gjykatë dhe nuk hetojnë detaje të vogla të çështjeve, nuk kërkojnë dosje ose regjistrime, ose nuk marrin përsipër detyra administrative), futja e një sistemi stimulues që inkurajon zgjidhjen dhe jo vetëm shtyrjen e vazhdueshme të çështjeve; ndër të tjera.
- Miratimi i parimeve të drejtësisë me në qendër qytetarin në zbatimin e MMP. Kjo përfshin kryerjen e anketave periodike të kënaqëshmërisë së klientit. Kjo gjithashtu përfshin adoptimin e një qasjeje shumë disiplinore, siç është rekomanduar edhe në Opsionin 2.
- Të përcaktohen, miratohen dhe zbatohen praktikrat dhe standardet etike për të garantuar cilësinë e lartë të ndihmës juridike (siç ka bërë ANJF në fushën e së drejtës civile dhe administrative), siç është rekomanduar edhe në Opsionin 2.



- Përcaktimin dhe konstituimin e organit mbikëqyrës, i cili konform këtij modeli, do të ketë kompetencë të plotë sa i përket mbikëqyrjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve juridike falas dhe atë të përfaqësimit në gjykatë dhe organet administrative. Ky mekanizëm do të mundëson identifikimin e mangësive në ofrim të shërbimeve të ndihmës juridike falas dhe atë të përfaqësimit dhe më pas evitimin e tyre me qëllim që ndihma juridike falas të jetë në funksion të qasjes në drejtësi për qytetarët që i plotësojnë kushtet ligjore.
- Për mbrojtësit publik të punësuar në ANJF, do të përcaktohen kushtet e punës konform përgjegjësive dhe përgatitjes akademike dhe profesionale që ata kanë, siç është rekomanduar edhe në Opsionin 2. Përcaktim ligjor duhet që të jetë kushti i Provimit të Jurisprudencës dhe përvoja profesionale juridike që duhet të plotësojnë Mbrojtësit Publik të punësuar në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.
- Poashtu, është i nevojshëm një specifikim më i detajuar në mënyrë që të ketë një aplikim uniform të vlerësimit të kriterëve të ndihmës juridike falas (që është elaboruar edhe në Opsioni 2).
- Mungesa e të dhënave të zbërthyera që është hasur në përgatitjen e këtij Koncept Dokumenti tregon nevojën e madhe që ekziston për një Sistem Informativ Ndërinstitucional të SNJ, i cili mund të jetë po aq i thjeshtë sa një aplikim që anëtarët e ndryshëm përbërës të SNJ-së/ndihma ligjore u ofrojnë anëtarëve për të regjistruar dhe shkëmbyer informacionin bazë për ndihmën e dhënë, rezultatet, sfidat, etj. Kjo do të mundësonte monitorimin e obligimit të Qeverisë së Kosovës sipas ligjit vendor dhe atij ndërkombëtar për të ofruar ndihmë juridike të cilësisë së lartë për personat që kualifikohen për të njëjtën;
- Elementet e një Sistemi të Ndihmës Juridike të forcuar duhet të përfshijnë: (1) kryerjen e trajnimeve të përbashkëta; dhe (2) mbajtjen e takimeve të shpeshta dhe periodike të SNJ-it të konsoliduar për të ndarë strategjitë, informacionin, sfidat dhe zgjidhjet, praktikat më të mira, etj. Kjo duhet të jetë nën përgjegjësinë e ANJF-së si agjenci kryesore e Qeverisë së Kosovës e dedikuar për ndihmën juridike të organizuar dhe koordinuar. Duhet të theksohet se deri vonë ky funksion, në një pjesë të madhe, është kryer nga bashkëpunimi ndërkombëtar, i cili nuk është plotësisht i qëndrueshëm.
- Në kuadër të përcaktimit ligjor, duhet që të përcaktohet kompetenca e Fakulteteve Juridike që të organizojnë Klinika për Ndihmë Juridike Falas dhe përcaktimin e nivelit të ndihmës juridike që mund të ofrojnë. Në kuadër të përcaktimit ligjor, duhet që të përcaktohet poashtu kompetenca e OJQ-ve sa i përket ofrimit të Ndihmës Juridike Falas dhe përcaktimin e nivelit të ndihmës juridike që mund të ofrojnë duke pas për bazë dhe të mundur edhe aspektin e partneritetit me ANJF.

- Qasjen e nevojshme dhe e kontrolluar e ANJF-së në baza të të dhënave në Gjykatë dhe Prokurori, me qëllim të lehtësimit të komunikimit, njoftimit të Agjencisë me Gjykatat për lëndë konkrete, është poashtu e nevojshme sipas këtij Opsioni, ngjashëm me Opsionin 2.

## **Përparësitë dhe mangësitë e Opsionit të Tretë**

Ndërsa një sistem i pastër i mbrojtësve publik mund të ofrojë disa përparësi në standardizimin dhe kontrollin e cilësisë së ndihmës juridike falas, sfidat në implementimin e tij janë të mëdha dhe të ndërlikuara. Këto sfida përfshijnë ndryshimi i një modeli të tillë mund të përballet me rezistencë për shkak të ndryshimeve rrënjësore që propozon në krahasim me praktikatat aktuale dhe mund të kërkojë një periudhë të gjatë adaptimi për të garantuar një kalim të suksesshëm. Prandaj, çdo vendim për të ndjekur këtë rrugë duhet të marrë në konsideratë këto faktorë dhe të planifikojë hapat e zbatimit me kujdes dhe përkushtim ndaj transparencës, pjesëmarrjes së gjerë dhe vlerësimit të vazhdueshëm të impaktit.

### **Përparësitë**

1. **Standardizimi i Shërbimit:** Ofron një nivel të unifikuar të cilësisë së ndihmës juridike, me mbrojtësit publik të trajnuar dhe të specializuar në të drejtat dhe procedurat ligjore.
2. **Përgjegjshmëria dhe Transparenca:** Lehtëson mbikëqyrjen dhe rregullimin e shërbimeve të ndihmës juridike, duke qenë se mbrojtësit publik janë punonjës të shtetit dhe janë nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë.
3. **Qasje e Drejtpërdrejtë për Grupet në Nevojë:** Mund të synojë më mirë dhe të arrijë grupet e marginalizuara ose të cenueshme, duke ofruar një qasje më të drejtpërdrejtë dhe të përshtatshme të shërbimeve.

### **Mangësitë:**

- **Ndryshimi Rrënjësor:** Vendosja e një sistemi të pastër të mbrojtësve publik kërkon një ndryshim të madh në strukturën aktuale juridike dhe administrative, i cili mund të hasë rezistencë institucionale dhe profesionale.
- **Mungesa e Infrastrukturës dhe Trajnimit:** Një sistem i tillë kërkon investime të mëdha fillestare në trajnimin e mbrojtësve publik dhe në ndërtimin e infrastrukturës së duhur administrative dhe logjistike.
- **Rreziku i Mbipopullimit dhe Mbingarkesës:** Mbrojtësit publik mund të përballen me një volum të lartë rastesh, duke rrezikuar cilësinë e mbrojtjes dhe kohën e reagimit.

- **Sfidat e Pranueshmërisë:** Ndryshimi në një model të tillë mund të mos pranohet lehtë nga publiku dhe profesionistët ligjor.
- **Qëndrueshmëria e stafit:** ANJF mund të përballet ndër vite me lëvizje të shpeshta të stafit që ofron ndihmë juridike falas, që kërkon buxhet dhe përpjekje shtesë për rekrutimin dhe trajnimin e zyrtarëve të rinj.
- **Centralizimi dhe Kontrolli:** Përqendrimi i shërbimeve të ndihmës juridike në duart e ANJF-së mund të krijojë rrezikun e një forme të monopolizimit shtetëror mbi këto shërbime, duke limituar inovacionin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë

## Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës. Ndikimet e pritura vlejnë për të gjitha e shqyrtuara në Kapitullin 3.

Figura 12 - Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

| Kategoritë e ndikimeve               | Ndikimet përkatëse të identifikuara   |
|--------------------------------------|---|
| Ndikimet ekonomike                   | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta  |
| Ndikimet shoqërore                   | Ndikime në të drejtat e qytetarëve dhe informimin më të mirë të publikut                                  |
| Ndikimet mjedisore                   | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta  |
| Ndikimet në të drejtat themelore     | Ndikime në qasje në drejtësi rrjedhimisht në realizimin e të drejtave                                     |
| Ndikimi gjinor                       | Është më shumë ndikim.  |
| Ndikimet e barazisë sociale          | Parashihen masa për të adresuar sfidat që ballafaqohen kategori të veçantë – siç janë viktimat e ndjeshme |
| Ndikimet tek të rinjtë               | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta  |
| Ndikimet në ngarkesën administrative | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta  |
| Ndikimi i NMV-ve                     | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta  |

### Kapitulli 4.1. Ndikimet shoqërore

#### 4.1.1. Ndikimet në të drejtat e qytetarëve

Përmes Opsionit 1 të Koncept Dokumentin, të trajtuar më lartë e që vazhdon gjendjen ekzistuese, nuk pritët që të ketë ndonjë ndikim pozitiv në fushën e ndihmës juridike falas. Në mungesë të riorganizimit institucional të ndihmës juridike falas apo edhe ndërmarrjes së masave tjera, do të vazhdohet me efikasitetin e ulët në trajtimin e kërkesave për ndihmë juridike falas, ku veçanërisht problematike do të mbetet numri i vogël i përfituesve të ndihmës juridike falas. Vazhdimi i problemeve të njëjta, do të stimulonte gjithashtu vazhdimin e shkeljes së të drejtave të njeriut në Kosovë për shkak të pamundësisë së qasjes në ndihmën juridike falas rrjedhimisht qasjes në Drejtësi.

Masat e parapara në Opsionin 2 mund të ndikojnë dukshëm në përmirësimin e të drejtave të njeriut sa i përket qasjes në drejtësi. Një përparësi mund të jetë që do të reflektohet në pengesa dhe probleme të identifikuar të karakterit përmbajtësor, njëherit do të arrihen standarde e nevojshme në avancimin e ndihmës juridike falas krahas standardeve ndërkombëtare dhe reformës në sistemin e drejtësisë, si dhe do të arrihej efekti i nevojshëm në zgjidhjen e problemeve të cekura në këtë koncept dokument. Pjesë me shumë rëndësi është pjesa e unifikimit dhe koordinimit të institucioneve që ofrojnë ndihmë juridike në një institucion të vetëm i cili do të ketë mandat për ofrim të ndihmës juridike falas. Ky opsion mundëson që ndihma juridike të ketë reformim në aspektin organizativ dhe funksional.

Opsioni 3, që është opsioni për ndryshime organizative ligjore ndikon më së shumti në ndihmën juridike falas. Përmes këtij opsion do të trajtohen dhe eliminohen problemet ligjore të identifikuar në praktikë e të cilat janë kualifikuar si pengesë për ofrim dhe funksionim të ndihmës juridike falas. Pjesë me shumë rëndësi është pjesa e unifikimit dhe koordinimit të institucioneve që ofrojnë ndihmë juridike në një institucion të vetëm i cili do të ketë mandat për ofrim të ndihmës juridike falas. Ky opsion mundëson që ndihma juridike të ketë reformim në aspektin organizativ, funksional dhe përmbajtësor. Kjo për faktin se do të lëvizet nga gjendja aktuale që është dhe do të arrihen standarde të larta në avancimin e ndihmës juridike falas krahas standardeve ndërkombëtare dhe reformës në sistemin e drejtësisë.

#### 4.1.2. Ndikimet në informimin më të mirë të publikut

Sa më e reformuar dhe avancuar të jetë ndihma juridike falas, kjo do të jetë më afër qytetarit dhe nevojave të tij për shërbimin e ndihmës juridike falas rrjedhimisht qasjes në drejtësi si një e drejtë fundamentale e njeriut. Rrjedhimisht Opsionet 2 dhe 3 të trajtuar kanë përparësi të dukshme krahasuar me opsionin 1. Në kuadër të Opsionit të 2 dhe 3, duket se qytetari do të jetë në qendër sa i përket ndihmës juridike falas duke përfshi edhe informimin e duhur në kohën e duhur dhe kjo do të jetë më pozitive se sa tjera.

## Kapitulli 4.2. Ndikimet në drejtat themelore

#### 4.2.1. Mbikëqyrja dhe monitorimi i ndihmës juridike falas

Një ANJF efikase që mbikëqyr dhe monitoron ndihmën juridike falas ndikon që ndihma juridike falas të jetë efikase, profesionale dhe llogaridhënëse për ata që do të ofrojnë. Për të siguruar një mbikëqyrje dhe monitorim të duhur, janë dy elemente kyçe që do të konsiderohen në kuadër të opsioneve të trajtuara. Së pari, 1) unifikimi i mekanizmave institucional që ofrojnë ndihmë juridike në një mekanizëm që është ANJF dhe 2) fuqizimi i ANJF-së me kompetencë të mbikëqyrjes dhe monitorimit përmes mekanizmave përkatës të saj. Opsioni 1 nuk e mundëson këtë ndryshim dhe reformë pasi nuk është e mundur, ndërsa Opsioni 2 siguron themelimin e mekanizmit për mbikëqyrje por jo edhe unifikimin të plotë institucional të ndihmës juridike falas (së paku jo menjëherë në vitet e para). Opsioni 3, sigurisht që përkrah edhe unifikimin e mekanizmave institucional dhe mekanizmin e mbikëqyrjes dhe monitorimit.

#### 4.2.2. Qasja në drejtësi

E drejta për qasje në drejtësi është ndër të drejtat themelore të njeriut, e cila i mundëson realizim dhe mbrojtje të drejtave subjektive qytetarëve. Mirëpo qasja në drejtësi me vete ka kosto e cila për një pjesë të qytetarëve është e papërbalueshme dhe kjo shpesh e pamundëson qasjen në drejtësi. Pamundësia për tu qasur në drejtësi, rrjedhimisht është pamundësi e realizimit të drejtave subjektive dhe kjo mund të konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut. Andaj ndihma juridike falas është mekanizmi përkatës i cili mundëson qasje në drejtësi dhe realizim të drejtave.

Përmes këtyre masave, por edhe ndryshimeve organizative të ndihmës juridike falas, Opsioni 2 do të ketë qasje shumë pro aktive sa i përket krijimit të kushteve për qasje në drejtësi. Opsioni 3 është në funksion të plotë të qasjes në drejtësi për të gjithë ata qytetarë që kanë nevojë për ndihmë juridike dhe përmes saj qasje në drejtësi.

### Kapitulli 4.3. Ndikimet buxhetore

Tabela në vijim paraqet ndikimin buxhetor të Opsionit 2 të trajtuar në Koncept Dokument.

| <b>Kostoja totale</b>  | <b>Viti 0</b> | <b>Viti 1</b>       | <b>Viti 2</b>       | <b>Viti 3</b>       |
|--|---------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| Paga dhe Mëditje   | -             | 871,351.00          | 881,231.00          | 886,431.00          |
| Mallra dhe Shërbime  | -             | 2,352,768.00        | 2,220,768.00        | 2,220,768.00        |
| Komunali   | -             | 15,000.00           | 15,000.00           | 15,000.00           |
| Subvencione dhe Transfere  | -             | -                   | -                   | -                   |
| Kapitale   | -             | 175,000.00          | -                   | -                   |
| <b>Gjithsej</b>  | -             | <b>3,414,119.00</b> | <b>3,116,999.00</b> | <b>3,122,199.00</b> |
| <b>Burimet e Propozuara të Financimit</b>  |               |                     |                     |                     |
| Buxhet Shtesë nga KAB i Ardhshëm   | -             | 2,876,288.00        | 2,579,168.00        | 2,584,368.00        |
| Numri I puntoreve  |               | 42.00               |                     |                     |
| Paga dhe mëditje   | -             | 563,520.00          | 573,400.00          | 578,600.00          |
| Mallra dhe Shërbime  | -             | 2,132,768.00        | 2,000,768.00        | 2,000,768.00        |
| Komunali   | -             | 5,000.00            | 5,000.00            | 5,000.00            |
| Subvencione dhe Transfere  | -             | -                   | -                   | -                   |
| Shpenzime Kapitale   | -             | 175,000.00          | -                   | -                   |
| Partnerët Zhvillimor (donatorët)   | -             | -                   | -                   | -                   |
| KAB Ekzistues  | -             | 537,831.00          | 537,831.00          | 537,831.00          |
| Paga dhe mëditje   | -             | 307,831.00          | 307,831.00          | 307,831.00          |
| Mallra dhe Shërbime  | -             | 220,000.00          | 220,000.00          | 220,000.00          |
| Komunali   | -             | 10,000.00           | 10,000.00           | 10,000.00           |
| Subvencione dhe Transfere  | -             | -                   | -                   | -                   |
| Shpenzime Kapitale   | -             | -                   | -                   | -                   |
| Borxh  | -             | -                   | -                   | -                   |
| Tjetër (p.sh. PPP)   | -             | -                   | -                   | -                   |
| <b>Gjithsej</b>  | -             | <b>3,414,119.00</b> | <b>3,116,999.00</b> | <b>3,122,199.00</b> |
| <b>Pjesa pa financim të paraparë</b>   |               |                     |                     |                     |
| <b>Komente shtesë për financim</b>   |               |                     |                     |                     |
| Koncept Dokumenti për ndihmë juridike falas, i Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas, paraqet kosto shtesë në vlerë prej 2,876,288.00 € për vitin 2025, për vitin 2026 shuma prej 2,579,168.00 € dhe në vitin 2026 shuma prej 2,584,368.00 €. |               |                     |                     |                     |

Ndërsa, tabela e radhës paraqet ndikimin buxhetor të Opsionit 3 të këtij Koncept Dokumenti.

| <b>Kostoja totale</b>  | <b>Viti 0</b> | <b>Viti 1</b>       | <b>Viti 2</b>       | <b>Viti 3</b>       |
|--|---------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| Paga dhe Mëditje   | -             | 1,677,751.00        | 1,687,831.00        | 1,707,831.00        |
| Mallra dhe Shërbime  | -             | 577,200.00          | 493,500.00          | 493,500.00          |
| Komunali   | -             | 18,000.00           | 18,000.00           | 15,000.00           |
| Subvencione dhe Transfere  | -             | -                   | -                   | -                   |
| Kapitale   | -             | 350,000.00          | -                   | -                   |
| <b>Gjithsej</b>  | -             | <b>2,622,951.00</b> | <b>2,199,331.00</b> | <b>2,216,331.00</b> |
| <b>Burimet e Propozuara të Financimit</b>  |               |                     |                     |                     |
| <b>Buxhet Shtesë nga KAB i Ardhshëm</b>  | -             | <b>2,077,120.00</b> | <b>1,661,500.00</b> | <b>1,681,500.00</b> |
| <b>Numri I puntoreve</b>   |               | <b>98.00</b>        |                     |                     |
| <i>Paga dhe mëditje</i>  | -             | <i>1,369,920.00</i> | <i>1,380,000.00</i> | <i>1,400,000.00</i> |
| <i>Mallra dhe Shërbime</i>   | -             | <i>357,200.00</i>   | <i>273,500.00</i>   | <i>273,500.00</i>   |
| <i>Komunali</i>  | -             |                     | <i>8,000.00</i>     | <i>8,000.00</i>     |
| <i>Subvencione dhe Transfere</i>   | -             | -                   | -                   | -                   |
| <i>Shpenzime Kapitale</i>  | -             | <i>350,000.00</i>   | -                   | -                   |
| <b>Partnerët Zhvillimor (donatorët)</b>  | -             | -                   | -                   | -                   |
| <b>KAB Ekzistues</b>   | -             | <b>537,831.00</b>   | <b>537,831.00</b>   | <b>537,831.00</b>   |
| <i>Paga dhe mëditje</i>  | -             | <i>307,831.00</i>   | <i>307,831.00</i>   | <i>307,831.00</i>   |
| <i>Mallra dhe Shërbime</i>   | -             | <i>220,000.00</i>   | <i>220,000.00</i>   | <i>220,000.00</i>   |
| <i>Komunali</i>  | -             | <i>10,000.00</i>    | <i>10,000.00</i>    | <i>10,000.00</i>    |
| <i>Subvencione dhe Transfere</i>   | -             | -                   | -                   | -                   |
| <i>Shpenzime Kapitale</i>  | -             | -                   | -                   | -                   |
| <b>Borxh</b>   | -             | -                   | -                   | -                   |
| <b>Tjetër (p.sh. PPP)</b>  | -             | -                   | -                   | -                   |
| <b>Gjithsej</b>  | -             | <b>2,614,951.00</b> | <b>2,199,331.00</b> | <b>2,219,331.00</b> |
| <b>Pjesa pa financim të paraparë</b>   |               |                     |                     |                     |
| <b>Komente shtesë për financim</b>   |               |                     |                     |                     |
| Koncept Dokumenti për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, paraqet kosto shtesë në vlerë prej 2,077,120.00 € për vitin 2025, për vitin 2026 shuma prej 1,661,500.00 € dhe në vitin 2027 shuma prej 1,681.500.00 €. |               |                     |                     |                     |

## Kapitulli 4.4: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Kanë ekzistuar sfida në sigurimin e të dhënave të caktuara, siç është përmendur më lartë në këtë Koncept Dokument, mirëpo pjesa më e madhe e tyre janë siguruar të cilat e kanë fuqizuar shumë përmbajtjen e këtij Koncept Dokumenti.

## Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Në vijim është paraqitur plani për komunikimin dhe konsultimin e këtij Koncept Dokumenti, që përfshin aktivitete të ndryshme në këtë drejtim.

Procesi i konsultimit synon:

Marrjen e opinionit nga palët e interesuara lidhur me politikën e re në aspekt të përgjithshëm, si dhe me masat specifike dhe elementet tjera të saj në veçanti (për më shumë shihni Kapitullin 3 të këtij Dokumenti).

| Qëllimi kryesor                                  | Grupi i synuar   | Aktiviteti   | Komunikimi/njoftimi         | Afati indikator | Buxheti i nevojshëm | Personi përgjegjës         |
|--|--|--|-----------------------------|-----------------|---------------------|----------------------------|
| Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara | KGJK, ZKM, MFPT, ANJF, ekspertët vendor dhe ndërkombëtar | Takimi publik  | E-mail                      | Shkurt 2024     |                     | Kryesuesja e grupit punues |
| Konsultimi i institucioneve relevante            | KGJK   | Takime/intervista me gjyqtarët, përveç atyre që ishin në përbërje të grupit punues | E-mail / thirrje telefonike | Shkurt 2024     |                     | Kryesuesja e grupit punues |
| Konsultimi i palëve të jashtme të interesuara    | Ekspertët nga Programi i USAID për Drejtësinë            | Takime online  | E-mail                      | Shkurt 2024     |                     | Kryesuesja e grupit punues |
| Konsultimi paraprak me shkrim                    | Institucionet e Republikës së Kosovës                    | Shpërndarja e draftit për konsultim paraprak                                       | E-mail                      | Qershor 2024    |                     | Kryesuesja e grupit punues |
| Konsultimi publik me shkrim                      | Të gjitha palët e interesuara                            | Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik dhe konsultimi me shkrim  | Platforma dhe e-mail        | Korrik 2024     |                     | Kryesuesja e grupit punues |

Figura 13 - Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument



## Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Çdo opsion ka përparësitë dhe mangësitë e veta, dhe zgjedhja e një sistemi të caktuar do të varet nga prioritetet specifike të Kosovës në ofrimin e ndihmës juridike falas. Ndërsa sistemi i pastër i mbrojtësve publik (Opsioni 3) ofron një qasje më të standardizuar dhe potencialisht më të kontrolluar ndaj ndihmës juridike, ai gjithashtu sjell sfida të mëdha në implementim dhe financim. Për këtë arsye, zgjedhja e modelit të duhur do të kërkojë një vlerësim të kujdesshëm të nevojave, burimeve dhe objektivave strategjike të Kosovës në fushën e ndihmës juridike, si dhe një angazhim të fortë ndaj procesit të reformës dhe qëndrueshmërisë afatgjate. Më poshtë janë paraqitur krahasimet e tre modeleve.

| Opsionet  | Përparësitë  | Mangësitë   |
|---|--|---|
| <b>Opsioni 1 - Pa Asnjë Ndryshim</b>                    | <p><b>Stabiliteti:</b> Ky opsion ofron një nivel të lartë të stabilitetit, duke e mbajtur sistemin aktual në vend dhe duke shmangur pasigurinë që mund të vijë nga ndryshimet.</p> <p><b>Familiariteti:</b> Profesionistët ligjorë dhe përdoruesit e sistemit janë tashmë të njohur me mënyrën se si funksionon sistemi aktual i ndihmës juridike falas.</p> | <p><b>Mungesa e Përmirësimeve:</b> Mosndërmarrja e asnjë veprimi në sistemin me të njëjtat mangësi dhe sfida, duke mos adresuar nevojat e ndryshuara të qytetarëve dhe kërkesat për një qasje më të drejtë dhe të qasshme në ndihmën juridike.</p> <p><b>Sfidat e Vazhdueshme:</b> Çështjet si mungesa e burimeve, infrastruktura e pakënaqshme, dhe mungesa e trajnimeve mbeten të pazgjidhura, duke e lënë sistemin të papërgjigjur ndaj nevojave të shoqërisë.</p> |
